

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Bachelor në “Drejtësi”

Koleji Universitar “Luarasi”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Enkeleda Olldashi

Enkeleda Olldashi

ME. Tildi Çadri

Tildi Çadri

(Prill/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc. në “Drejtësi”, të ofruar nga Kolegji Universitar “Luarasi”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Luarasi”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASh Nr. 324, datë 21.06.2010
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 271, datë 29.06.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Drejtësi”
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Kolegji Universitar “Luarasi”
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve	327 studentë
	Etj	

HYRJJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në "Drejtësi"

Kolegji Universitar "Luarasi", i licensuar për ushtrimin e aktivitetit si shkollë e lartë universitare jopublike, ka filluar aktivitetin e tij akademik në vitin 2003-2004 (me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi". Në bazë të aktit të licensimit shkolla ishte e nivelit universitar dhe ofronte programin e studimit me degën e vetme "Drejtësi" (me kohëzgjatje të studimit 4 vjet). Me Urdhër Nr. 71, datë 18.02.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për akreditimin institucional të programit dhe diplomës të Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike "Luarasi", është realizuar akreditimi i parë institucional si edhe akreditimi i programit të studimit të ciklit të parë dhe diplomës me titull "Jurist."

Me Urdhër Nr. 324, datë 21.06.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për miratimin e ndryshimit të programit të studimit "Drejtësi" të Shkollës së Lartë Private "Luarasi", është miratuar ndryshimi i programit të studimit në "Drejtësi" në SHLUJ "Luarasi" në program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me 180 kredite dhe me kohëzgjatje të programit 3 vite akademike. Në përfundim të studimit, sipas urdhërit, lëshohet "Diplomë e Nivelit të Parë (DNP)", në "Drejtësi."

Ky program studimi "Bachelor" në "Drejtësi" është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike me 180 kredite ku për secilin vit akademik janë 60 kredite (ECTS). Në këtë program studimi janë të përfshira dhe kreditet e praktikës mësimore (6 ECTS) (si lëndë që zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë akademik) dhe 7 ECTS për "Tezën e diplomës/Provimi Përfundimtar".

Me Urdhër Nr. 271, datë 29.06.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për akreditimin e programeve të studimit "Bachelor" në "Drejtësi" është realizuar akreditimi i programit të ciklit të parë Bsc në "Drejtësi".

Në vitin akademik 2016-2017, në kuadër të riakreditimit institucional, Kolegji Universitar "Luarasi", u akreditua për 6 vite akademike me Vendimin Nr. 115 datë 15.12.2017 të Bordit të Akreditimit.

Rezulton se në KU "Luarasi", programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Drejtësisë, janë të akredituara.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ):

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën:

Prof. As. Enkeleda Olldashi dhe ME. Tildi Çadri si ekspertë të jashtme vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ-ja u shoqërua nga specialistet e ASCAL, Msc. Ersi Dako dhe Msc. Xhiliola Bixheku. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Ersi Dako.

Më datë 29.03.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 11/7, datë 01.04.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, i hartuar nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit.

Përmes sistemit AMS, më datë 09.04.2019, si dhe me shkresë zyrtare Nr. 82 Prot., datë 10.04.2019, me lëndë "Përgjigje lidhur me draft-raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "Bachelor" në "Drejtësi", Institucioni përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Ekspertët u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:



1. Në lidhje me pikën 1 të komenteve të Institucionit:

Në faqen 10 të Draft-Raportit GVJ ka evidentuar mospërputhje mes deklarimeve të paraqitura në RVB dhe evidencave që e shoqërojnë atë në lidhje me stafin akademik.

GVB sqaron se kjo mospërputhje e konstatuar nga GVJ, kryesisht rritja e numrit për PAK (rreth 1/2 PAK per departament) vjen si rezultat i rritjes së numrit të studentëve të parashikuar për shkak se procesi i regjistrimit vazhdon deri në fillim të muajit dhjetor. Staf akademik i sipercituar lekon në të dyja ciklet e studimit të Fakultetit të Drejtësisë.

Sqarim nga GVJ: Mospërputhja e deklaruar në raport në fakt lidhet me të dhënat e stafit të brendshëm, i cili nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar nga vetë IAL (RVB dhe Tabelat që lidhen me këtë pikë), evidentojnë pasaktësi/mospërputhje. Si i tillë ky përcaktim nuk ndryshon pasi nuk ka evidencë apo sqarim për saktësimin e deklaramit.

2. Në lidhje me pikën 2 të komenteve të Institucionit:

Në faqen 15 të Draft-Raportit, standardi III.2, kriteri 4, GVJ konstaton se një pjesë e vogël e lëndëve mbulohen me staf akademik me kualifikim Msc.

GVB deklaron se institucioni është duke marrë masat e nevojshme për mbulimin e të gjitha lëndëve të ciklit të parë të studimit me lektorë me grada shkencore dhe tituj akademik për vitin akademik 2019-2020. Vit i cili në bazë të ligjit 80/2015 për arimin e lartë parashikon fillimin e programit të integruar të ciklit të dytë në Drejtësi.

Sqarim nga GVJ: Komenti i IAL është konfirmim i gjetjes së GVJ, prandaj vlerësimi i GVJ qëndron siç është.

3. Në lidhje me pikën 3 të komenteve të Institucionit:

Në faqen 21 të Draft-Raportit, kapitulli 6, GVJ konstaton se nuk përcaktohet saktësisht përkufizimi i strukturës së NJBSC nëse është njësi administrative apo akademike, me funksion ad- hoc apo e përhershme.

GVB sqaron se në bazë të nenit 103 të Ligjit 80/2015 për arsimin e lartë “ ... Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.” Si rrjedhojë, sic konstatohet nga neni 74 edhe nga organigrami e institucionit, NJBSC është strukturë në varësi të drejtëpërdrejtë të Rektorit.

Referuar konstatimit të GVJ se “...nuk përcaktohet saktësisht përkufizimi i strukturës së NJSBC-së, nëse ajo është konceptuar si njësi administrative apo akademike, me funksione ad-hoc apo e përhershme.” në nenin 92 të Rregullores së KU “Luarasi” (evidenca nr. 7) përcaktohet se: “Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (më poshtë NJBSC) është një njësi akademiko-administrative, kryen në mënyrë periodike realizimin, kontrollin, matjen dhe zhvillimin e cilësisë në KU “Luarasi”.

Sqarim nga GVJ: Në evidencat që i bashkëlidhen RVB, po ashtu edhe gjatë vizitës në vend, është konstatuar një paqartësi në mënyrën se si IAL e konsideron këtë njësi, e cila herë citohet si zyrë herë si njësi administrative. Në përcaktimin dhe funksionet reale të NJSBC-së, ashtu siç është cituar në Draft-RVJ, kjo njësi ushtron aktivitet të sigurimit të cilësisë, megjithatë përbërja e saj (staf akademik me kohë të plotë) si dhe mungesa e një përcaktimi të saktë strukturor (kujtojmë që njësia ka 5 anëtarë dhe asnjë staf administrativ të dedikuar) lë më shumë të kuptohet që ky është

një komision i cili mblidhet herë pas here për të ndarë detyrat përkatëse, ad hoc. Gjithshtu, gjatë diskutimit me NJSBC pikërisht për këtë çështje, u deklarua se kjo është një njësi e pavarur e lidhur drejtpërdrejtë me Rektorin. Sa më lart, nuk ka ndryshime për këtë pikë.

4. Në lidhje me pikën 4 të komenteve të Institucionit:

Në faqen 24 të Draft-Raportit, pika 3 e konkluzioneve të vlerësimit, GVJ kërkon që NJSBC të definojë me saktë funksionet e saj si njësi administrative me detyra të qarta dhe përshkrime pune për të gjithë anëtarët e saj.

Referuar kësaj pike si më poshtë vijon komenti përkatës: ...IAL citon detyrat e anëtarëve të NJSBC.

Sqarim nga GVJ: GVJ-së, gjatë vlerësimit paraprak dhe gjatë vizitës në vend, nuk ju vu në dispozicion asnjë informacion i tillë. Për më tepër, detyrat e përshkruara nga IAL në koment nuk janë referuar se në cilin akt nënligjor apo dokumentacion citohen. Sa më lart, komenti i IAL nuk merret parasysh.

5. Në lidhje me pikën 5 të komenteve të Institucionit:

Në faqen 27, Kapitulli "Politikat e Formimit të Studentëve", GVJ shprehet se: "...në disa prej lëndëve të kësaj kurrikule, stafi akademik në statusin e lektorit nuk ka një përvojë të pasur akademike edhe pse është e mirëkuptueshme që pjesë e stafit akademik duhet të jenë edhe pedagogët pa përvojë, të cilët duhet të mbështeten nga stafi me përvojë. Ndërmjet anëtarëve të stafit akademik GVJ konstatoi një frymë bashkëpunimi akademik."

Përsa më sipër GVB mendon se GVJ nuk disponon të gjitha të dhënat e duhura për të vlerësuar përvojën akademike të stafit akademik. GVB deklaroi se ky staf është rekrutuar pranë KU "Luarasi" nëpërmjet një procesi rekrutimi rigoroz bazuar në kriteret e përcaktuara nga departamentet përkatëse dhe në Statutin e Institucionit.

Sqarim nga GVJ: Komenti i institucionit në lidhje me këtë paragraf nuk përbën argument, pasi mungesa e përvojës akademike në mësimdhënie nuk do të thotë mungesë të transparencës në proceset e rekrutimit. Ky paragraf është formuluar për të evidentuar faktin që disa pedagogë (me Msc) janë pa përvojën e duhur akademike, e cila nuk kupton përvojën e formalizuar në tituj akademik, por fryma e bashkëpunimi ndërmjet stafit me përvojë është për tu evidentuar. Për sa më sipër paragrafi riformulohet si më poshtë:

"Në lidhje me formimin akademik dhe titujt apo gradat shkencore që stafi akademik ka të lidhura këto me lëndët që ata japin, GVJ konstatoi që: në shumicën e lëndëve të këtij programi studimi, stafi ka eksperiencën e duhur akademike dhe përvojën e duhur praktike që në disa prej lëndëve të kurrikulës është e domosdoshme (psh. në lëndë të tilla si: E drejta administrative; E drejta e detyrimeve; E drejta familjare; E drejta penale; E drejta civile; Historia e shtetit shqiptar dhe së drejtës në Shqipëri...etj). Në disa prej lëndëve të kësaj kurrikule, stafi akademik në statusin e lektorit nuk ka përvojën e duhur akademike (të formalizuar në tituj akademik) edhe pse kjo është e mirëkuptueshme, pasi pjesë e stafit akademik mund të jenë edhe pedagogët pa këtë lloj përvojë akademike, të cilët mbështeten dhe asistohen akademikisht nga stafi tjetër i brendshëm. Ndërmjet anëtarëve të stafit akademik GVJ konstatoi një frymë bashkëpunimi akademik (Fq. 30 e RVJ)

Komenti i Institucionit çon në riformulim të paragrafit, por pa ndryshuar thelbin e tij. Ky riformulim bëhet pasi nuk duhet që në RVJ të ketë paragrafë të cilat nuk tregojnë apo reflektojnë atë që eksperti ka parë dhe ka konstatuar gjatë vizitës dhe përmes dokumentacionit.

6. Në lidhje me pikën 6 të komentit të Institucionit:

Në faqen 42, Kapitulli “Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar dhe marrëdhënia me publikun”, GVJ shprehet në konkluzionin 4 të vlerësimeve se: “KU “Luarasi” duhet të ndërmarrë masa për përfshirjen më të madhe të studentëve të këtij programi studimi në kërkimin shkencor dhe projekteve të brendshme të aplikuar”.

GVB sqaron se në studentët e ciklit të parë të studimeve brenda formimit të tyre teorik dhe praktik janë angazhuar si bashkëautor në konferencat shkencore dhe aktivitetet e tjera trajnuese dhe kualifikuese të organizuara nga KU “Luarasi”.

Sqarim nga GVJ: GVJ identifikoi se përfshirja e studentëve në të tilla aktivitete, aktualisht, është në numër shumë të ulët, bazuar dhe nga të dhënat sasimore dhe cilësore që IAL ka vetëdeklaruar. Si i tillë, ky vlerësim nuk ndryshon.



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të përmirësohet raporti pedagog i brendshëm -pedagog i jashtëm.
- b) Të realizohet sigurimi i literaturës elektronike, veçanërisht të periodikëve.
- c) Të ndërtohet një bibliotekë elektronike.
- d) Të realizohet një program i qartë për mënyrën sesi do të realizohet kërkimi shkencor;
- e) Të bëhet një koordinim më i efektshëm ndërmjet departamenteve dhe NJSBC si për vjeljen e informacionit ashtu edhe për reflektimin mbi rezultatet e vlerësimit.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin *“Të përmirësohet raporti pedagog i brendshëm-pedagog i jashtëm”*, Institucioni ka marr masa për rekrutimin e personelit akademik dhe përmbushjen e kriterëve ligjore duke siguruar 7 pedagogë të brendshëm në secilin Departament të Fakultetit të Drejtësisë. Aktualisht në Fakultetin e Drejtësisë, departamentet e së cilit janë të angazhuar drejtpërdrejtë në realizimin e programit Bsc. në “Drejtësi”, rezultojnë me 47 pedagogë (21 të brendshëm dhe 26 të jashtëm). Raporti pedagog i brendshëm-pedagog i jashtëm në departamente rezulton 1:1.23, ndërkaq raporti pedagog i brendshëm – pedagog i jashtëm të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik 2018-19, rezulton 1.6:1 (18 PAE/11 PAK). *GVJ konstaton se ky rekomandim është përmbushur.*
- b) Për rekomandimin *“Të realizohet sigurimi i literaturës elektronike, veçanërisht të periodikëve”*, Institucioni ka rritur fondin e librave fizikë në Bibliotekën e institucionit dhe aktualisht rezultojnë 350 tituj librash fizikë në funksion të programit të studimit, që plotësojnë kërkesat minimale për literaturën e detyrueshme sipas Syllabuseve të lëndëve. Institucioni gjithashtu ka vënë në dispozicion dhe bibliotekën online eëë.questia.com, për të cilën i është dhënë akses stafit dhe studentëve. *GVJ gjykon se rekomandimi është përmbushur* edhe pse për këtë komponent kërkohet akoma më shumë angazhim nga Institucioni për adresimin e plotë të rekomandimit si një proces dinamik për ofrimin e literaturës sa më të përditësuar dhe më sasiore.
- c) Për rekomandimin *“Të ndërtohet një bibliotekë elektronike”*, Institucioni ka iniciuar zhvillimin e një sistemi teknologjik për menaxhimin e Bibiliotekës. Sistemi, sikundër deklarohet dhe në RVB dhe gjatë vizitës në vend, është në fazë ndërtimi. GVJ ju paraqit një Manual i funksionimit të këtij sistemi i cili pritet të implementohet në vijim. Ky sistem, sipas vetëdeklarimit, do të mundësojë kërkimin e librave në bibliotekë on-line, regjistrimin e përdoruesve të rinj, rezervimin për huamarrje të librave, gjenerimin e raporteve për librat e dhëne etj. GVJ gjykon se qasja e institucionit për adresimin e rekomandimit është e duhur. *GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur kryesisht.*
- d) Për rekomandimin *“Të realizohet një program i qartë për mënyrën sesi do të realizohet kërkimi shkencor”*, Institucioni përmes Strategjisë së tij Institucionale të Kërkimit Shkencor ka vendosur disa objektiva që lidhen me performancën shkencore të stafit akademik; marrëdhëniet e bashkëpunimit me insitucione homologe brenda dhe jashtë vendit; si dhe organizimin e projekteve, konferencave e ëorkshop-eve, botimit të revistës periodike të KU “Luarasi”, “Mendimi” me ISSN 2311-0961 etj. Vlen të përmendet dhe përfshirja e lëndës “Klinika Ligjore” e cila vjen si produkt i projektit të zhvilluar me Fondacionin “Shoqëria e Hapuar”. *GVJ gjykon se Institucioni e ka përmbushur këtë rekomandim.*
- e) Për rekomandimin *“Të bëhet një koordinim më i efektshëm ndërmjet departamenteve dhe NJSBC si për vjeljen e informacionit ashtu edhe për reflektimin mbi rezultatet e vlerësimit”*, Institucioni në përputhje dhe me ndryshimet ligjore ka formalizuar dhe ngritur NJSBC si

strukturë të dedikuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo njësi, përmes Planit të Veprimtarisë, ka mundur të realizojë proces të vlerësimit të procesit mësimor në auditor, duke e koordinuar me Dekanin ose Drejtuesin e Departamentit. Roli i NJSBC ka qenë identifikues dhe sugjerues mbi metodikat e mësimdhënies. GVJ konstatoi se Njësia ruan marrëdhënie të drejtpërdrejta me Departamentet dhe ka marrë iniciativa për identifikimin e trajnimeve të nevojshme sipas kërkesave të Departamenteve. *GVJ gjykon se Institucioni e ka përmbushur këtë rekomandim.*



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Luarasi” synon të ofrojë për studentët njohuri të përgjithshme formuese në të drejtën publike, private dhe penale. Programi i studimit përmes grupit të lëndëve të formimit karakterizues të fushës së studimit (grupi i lëndëve të kategorisë (B), mundëson formimin e studentëve për vijimësinë e studimeve në varësi të kërkesave të tyre për një punësim të mëvonshëm në fushën e profesioneve të lira si: avoka, noter, jurist në shoqëritë tregtare, jurist në shoqëritë shtetërore, si dhe, si jurist në institucione të ndryshme në administratën publike. Për përmbushjen e këtij misioni, në këtë program studimi, ky grup lëndësh realizohet përmes trajtimit të aspekteve teorike dhe rasteve praktike të marra nga proceset gjyqësore apo rastet që paraqiten pranë “Klinikës Ligjore”, si një projekt i atashuar pranë këtij programi dhe si pjesë e kurrikulës së tij. Ky program studimi Bachelor në “Drejtësi” është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike me 180 kredite ku për secilin vit akademik janë 60 kredite (ECTS). Në këtë program studimi janë të përfshira dhe kreditet e praktikës mësimore (6 ECTS), si lëndë që zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë akademik dhe 7 ECTS për ‘Tezën e diplomës/Provimi Përfundimtar’.

Nëpërmjet këtij programi studimi “Bachelor” synohet edhe dhënia e ekspertizës ligjore për nevojat e të tretëve. Institucioni tregon në këtë drejtim dhe një angazhim konkret përmes realizimit të bashkëpunimeve me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si në lidhje me përmbushjen e misionit të tij akademik dhe shkencor, ashtu dhe me ofrimin e shërbimeve juridike për të tretët (sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ gjatë vizitës në institucion: “Kontratë grant Nr. 8237”).

Programi Bachelor në “Drejtësi” ka për qëllim të ofrojë për studentët një kombinim të njohurive që lidhen me fushën e jurisprudencës dhe me fushat e tjera të disiplinave të përafërta me të, duke i ndihmuar ata t’u përshtaten kërkesave të tregut të punës. Ky program është projektuar për të pajisur studentët me njohuri, aftësi, mendim kritik dhe eksperiencë, që ju mundëson të diplomuarve të tij, të hyjnë me sukses në botën e profesioneve duke përdorur aftësitë e kultivuara.

Për të realizuar mësimdhënie cilësore, Institucioni përpiqet të përmirësojë standardet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, nëpërmjet trajnime të organizuara nga njësitë bazë dhe NJSBC. GVJ, mbështetur në RVB, konstaton që KU “Luarasi” mbështet kërkimin shkencor ndërdisiplinor ndërmjet të gjitha njësive bazë, si edhe në partneritet me institucione të tjera. Aktivitetet dhe produktet kërkimore synojnë jo vetëm të rrisin ndikimin në shkëmbimin e njohurive në komunitetin shkencor por edhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik social të vendit përmes trajtimit të problematikave me zgjidhje krijuese e rekomandime të qarta politike.

Në funksion të realizimit të misionit akademik dhe shkencor në KU “Luarasi” organizohen takime mes profesorëve të ftuar jashtë këtij institucioni, me të cilët ndahet përvoja akademike dhe shkencore në funksion të procesit mësimor (ëëë.luarasi.edu.al).

GVJ nisur nga takimet e kryera gjatë vizitës në institucion konstaton që KU “Luarasi” është i angazhuar në zhvillimin intelektual, krijues dhe individual të studentëve të tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Luarasi” përputhet me qëllimin e tij për përgatitjen akademike të studentëve në fushën e drejtësisë. Përmes kurrikulës së harmonizuar në aspektin e lëndëve që ofrojnë njohuri të përgjithme formuese dhe atyre që ofrojnë njohuri më specifike në fushat e dy degëve të së drejtës (publike dhe private), synohet të ofrohen njohuri teorike/doktrinale dhe praktike formuese që synojnë të ndikojnë në vijimësinë e karrierës profesionale të studentëve pas përfundimit të këtij cikli të parë studimesh.</p> <p>Në vijimësinë e përmirësimit të vazhdueshëm akademik, ky program studimi i ciklit të parë në “Drejtësi” është përshtatur dhe me nevojën e tregut dhe kërkesën e studentëve për njohuri të lidhura më ngushtësisht me praktikën, duke përfshirë lëndë në disiplina me zgjedhje (në grupin (D) të kurrikulës) si lëndën e Klinikës Ligjore. Kjo disiplina, e zhvilluar më parë si një Klinikë Këshilluese për të tretë që edhe sot e vijon këtë mision të saj (sipas dokumentit “Kontratë grant Nr. 8237”), ka shërbyer si embrion për hartimin e programit të kësaj lënde duke synuar të nxisë studentët drejt të menduarit më praktik në zgjidhjen e problematikave ligjore, në fushën që ajo zhvillon njohuritë përkatëse (sipas dokumentit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga institucioni gjatë vizitës së GVJ Vendimi Nr.5 datë 21.04.2017 i Dekanatit të Fakultetit të Drejtësisë, “Për ndryshimin në kurrikulën e programit “Bachelor” në “Drejtësi”, nëpërmjet të cilit është bërë pjesë e kurikulës kjo lëndë).</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Ky program studimi “Bachelor” në “Drejtësi” gjendet i përshtatur me strategjinë institucionale të zhvillimit të Kolegjit Universitar “Luarasi” 2017-2020 (Evidencë 5 “Strategjia Institucionale e Zhvillimit 2017-2020”).</p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” është hartuar dhe zhvillohet përmes ofrimit të njohurive të formimit të përgjithshëm teorik në fushën e drejtësisë, duke mundësuar në të njëjtën kohë dhe përdorimin e tyre në lëndët e karakterit më të ngushtë profesional. Kjo realizohet përmes ofrimit të orëve në auditor, të cilat japin mundësinë e një trajtimi më</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.




	<p>praktik të informacionit teorik nëpërmjet case study. Harmonizimi i njohurive teorike të përftuara në një vit akademik të mëparshëm shërben për sintetizimin e tyre në një vit të mëpasshëm, duke iu dhënë mundësi studentëve të japin zgjidhje argumentuese të problematikeve që praktika e përditshme e gjykatave ofron.</p> <p>Lëndët që lidhen me disiplinat karakterizuese të këtij programi studimor të ciklit të parë (si e drejtë civile, e drejtë penale, e drejtë administrative, e drejtë familjare, e drejta e detyrimeve, etj.) zhvillohen në funksion të formimit më praktikë të njohurive të përftuara, gjë që mundëson të menduarit racional dhe analitik tek studentët (informacion i përftuar nga GVJ gjatë takimit në institucion me stafin akademik dhe studentët).</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi”, bazuar në përmbajtjen e kurrikulës së tij, përshtat nevojat e tregut përmes përfshirjes në programet e lëndëve përkatëse, të çështjeve dhe problematikave nga praktika gjyqësore dhe nga rastet që paraqiten pranë Klinikës Ligjore (të ngritur pranë Fakultetit të Drejtësisë).</p> <p>Stafi akademik i këtij programi studimi, përmes njohjes së praktikave që hasen në sistemin gjyqësor, mundëson përfshirjen teorike dhe praktike të zhvillimit të shkencës juridike në vendin tonë.</p> <p>Kurrikula e këtij programi studimi përfshin përveç lëndës “Klinika Ligjore” dhe lëndën “Praktika mësimore”, të cilat japin mundësinë e njohjes së tregut të punës nga ana e studentëve. Institucioni ofron për studentët dhe përmes praktikës mësimore krijimin e kontakteve me punëdhënësit si dhe fitimin e një eksperience për vijimin e mëtejshëm të studimeve më të thelluara në fushat ku ata kanë mundësi të identifikojnë dhe vetë.</p> <p>Zyra e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës mundësojnë një aftësim më të mirë të studentëve për tu prezantuar në një marrëdhënie të mundshme punësimi. Kjo zyrë mban kontakte të vazhdueshme me studentët përgjatë studimeve si dhe pas tyre (sipas takimit me zyrat përkatëse dhe dokumentacionit që institucioni mundësoi për GVJ gjatë vizitës: Urdhëri i Rektorit Nr. 10, datë 08.11.2018 “Për miratimin e personave përgjegjës për Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”; drafti i hartuar nga përgjegjësja e zyrës J.GJ “Për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës së Karrierës dhe Studentit”).</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	




Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” që Kolegji Universitar “Luarasi” ofron, ka në përmbajtjen e tij lëndë të cilat mundësojnë për studentët njohjen e legjislacionit dhe zhvillimit të brendshëm të së drejtës në fushën publike dhe private si dhe në atë ndërkombëtare. Në kurrikulën e këtij programi janë dhe lëndët e formimit të përgjithshëm ku përmes të cilave si p.sh., në lëndën “*Historia e Institucioneve dhe e Shtetit dhe së drejtës në Shqipëri*”, sigurohet ofrimi i dijeve dhe parimeve mbi të cilat në vendin tonë është ndërtuar sistemi ligjor, duke siguruar përmes këtij informacioni dhe njohjen e vlerave dhe traditave tona juridike në fushën përkatëse. Stafit akademik iu mundëson studentëve, përmes literaturës, njohjen e vlerave tonë kombëtare në fushën e së drejtës përmes dhe botime të profesorëve që kanë mundësuar dhe krijimin e këtij institucioni arsimor.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit Bachelor në Drejtësi në Kolegjin Universitar “Luarasi” përputhet me qëllimin e tij për përgatitjen akademike të studentëve në fushën e së drejtës publike dhe private. Kjo realizohet përmes harmonizimit të njohurive teorike dhe praktikës gjyqësore. Ky qëllim mundësohet të përmbushet nga ana e stafit akademik jo vetëm përmes orëve në auditor, por edhe përmes ndjekjes së proceseve gjyqësore (të lidhura me tematikat e programit).
2. Përmbajtja e kurrikulës përshtatet me nevojat që shoqëria ka për një zhvillim sa më social të jurisprudencës. Kjo nevojë identifikohet nga vetë studentët përmes pjesëmarrjes së tyre në ofrimin e shërbimit për ata që kërkojnë një këshillim ligjor. Si rezultat i këtij mekanizmi përthithës të nevojave të tregut, kurrikula ka bërë pjesë të saj dhe lëndë të tilla si “Klinika Ligjore”.
3. Nëpërmjet këtij programi studimi “Bachelor” realizohet dhënia e shërbimeve juridike tek të tretët, përmes projekteve që realizohen në kuadër të misionit të këtij programi.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura përgjegjëse akademike për programin e studimit Bachelor në “Drejtësi” është Fakulteti i Drejtësisë, i cili organizohet në 3 Departamente, respektivisht:

1. Departamenti i së Drejtë Publike;
2. Departamenti i së Drejtës Penale;
3. Departamenti i së Drejtës Civile.

Nga vlerësimi paraprak i dokumentacionit të vetëvlerësimit dhe evidencave deklarohet se Departamentet përgjegjëse, për vitin akademik 2018-2019 kanë në përberje të tyre 7 personel akademik efektiv, nga të cilët 3 prej tyre zotërojnë tituj akademik ose gradë shkencore.

Konkretisht, referuar Evidencës 13 të DVV “Për miratimin e personelit akademik per vitin 2018-19 (Vendim i Senatit Nr. 2, date 07.12.2018)”, përbërja e Departamenteve paraqitet si vijon:

1. Departamenti i së Drejtës Private:

7 PAE, nga të cilët 2 PAE me titull “Prof.As”, 2 me gradën “Dr” dhe 3 Msc.

7 PAK, nga të cilët 1 PAK me titull “Prof.”, 3 me gradën “Dr”, 1 Docent dhe 2 Msc.

2. Departamenti i së Drejtës Penale:

7 PAE, nga të cilët 1 PAE me titull “Prof.As”, 2 me gradën “Dr” dhe 4 Msc.

9 PAK, nga të cilët 8 PAK me gradën “Dr” dhe 1 Msc.

3. Departamenti i së Drejtës Publike:

6 PAE, nga të cilët 2 PAE me gradën “Dr” dhe 4 Msc.

7 PAK, nga të cilët 1 PAK me titull “Prof.”, 1 me titull “Prof.As”, 3 me gradën “Dr” dhe 2 Msc.

Evidentohet një mospërputhje mes deklarimeve të paraqitura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe evidencave që e shoqërojnë atë në lidhje me stafin e brendshëm për këtë program studimi. Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (Tabelat 1 dhe 2, fq. 15-17 të RVB) përbërja e Departamenteve paraqitet si vijon:

1. Departamenti i së Drejtës Private:

7 PAE, nga të cilët 2 PAE me titull “Prof.As”, 2 me gradën “Dr” dhe 3 Msc.

8 PAK, nga të cilët 1 PAK me titull “Prof.”, 3 me gradën “Dr”, 1 Docent dhe 3 Msc.

2. Departamenti i së Drejtës Penale:

7 PAE, nga të cilët 1 PAE me titull “Prof.As”, 2 me gradën “Dr” (sipas tabelës 1 të RVB janë dhënë 4 Dr.) dhe 4 Msc.

10 PAK, nga të cilët 9 PAK me gradën “Dr” dhe 1 Msc.

3. Departamenti i së Drejtës Publike:

7 PAE, nga të cilët 3 PAE me gradën “Dr” dhe 4 Msc.

8 PAK, nga të cilët 1 PAK me titull “Prof.”, 1 me titull “Prof.As”, 4 me gradën “Dr”, 1 Doktorant dhe 1 Msc.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Nga vlerësimi paraprak, por dhe gjatë vizitës në vend u konstatua nga GVJ se struktura e Fakultetit të Drejtësisë nuk ka patur ndryshime dhe është sipas parashikimeve në Statutin e KU “Luarasi” dhe Urdhërit Nr. 188, datë 15.05.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për riorganizimin e njësive kryesore të Institucionit të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë Private “Luarasi”. Aktualisht organigrama e Fakultetit rezulon si në tabelën 1 të Anekseve.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamenteve përgjegjës (Tabela 2 dhe 3 e Anekseve)

Programi ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë, në përbërje të së cilit janë tre departamente, respektivisht Departamenti i së Drejtës Penale, Departamenti i së Drejtës Private dhe Departamenti i së Drejtës Publike. Të dhënat për Departamentet përgjegjëse janë reflektuar sa më lart.

GVJ konstaton se për vitin akademik 2018 – 19, ka mospërputhje në të dhënat e deklaruar në Dosjen e vetëvlerësimit, përkatësisht në Evidencën “Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës – Tabela 13” dhe Evidencën “Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe ndihmës akademik për programin e studimit - Tabela 4”. Në Tabelën 13 rezultojnë 28 pedagogë të angazhuar ndërkaq Tabela 4 rezultojnë 29 pedagogë. Gjithashtu vihet re mospërputhje dhe midis Evidencës “Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës – Tabela 13” dhe Evidencës “Të dhënat e stafit akademik për programin e studimit sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre - Tabela 5”, për vitet akademike 2017-18 dhe 2016-17, për numrin e pedagogëve të deklaruar dhe atyre të evidentuar në planet mësimore për vitet respektiv.

Në planin mësimor të lidhur me personelin akademik rezulton se një pedagog deklarohet për një nga lëndët e angazhuar si Doktorë Shkencash dhe në lëndën tjetër në po të njëjtin plan mësimor deklarohet “Doktorante”.

Në këto departamente për vitin akademik 2017-18 kanë dhënë mësim (Tabela 5 e anekseve të DVV) 26 pedagogë prej të cilëve 17 janë PAE dhe 9 janë PAK. Ndërmjet PAE rezultojnë 8 pedagogë me tituj dhe gradë dhe 9 asistentë me Msc: 1 PAE profesor i asociuar dhe 7 doktor shkencash (Dr/Phd).

Përsa i takon PAK, kualifikimi i tyre paraqitet si vijon: 5 doktorë shkencash (Dr/PhD) dhe 4 Msc. Përsa i takon raportit PAE/PAK në Fakultetin e Drejtësisë sipas gradave situata paraqitet si vijon: në nivelin profesor PAE 0/PAK 0; në nivelin profesor i asociuar PAE 1/PAK 0; në nivelin doktor shkencash PAE 6/PAK 3; në nivelin pedagogë në procesin e marrjes së gradës doktor shkencash PAE 7/PAK 3; në nivelin asistentë me Msc PAE 9/PAK 4. Rezulton se ka një numër relativisht të lartë të stafit akademik PAE dhe PAK me Msc, të angazhuar në këtë program studimi.

Në Fakultetin e Drejtësisë në vitin akademik 2016-2017 (Tabela 5 e anekseve të DVV) kanë dhënë mësim 28 pedagogë prej të cilëve 18 janë PAE dhe 10 janë PAK. Ndërmjet PAE 8 janë me tituj dhe grada: 1 profesor i asociuar, 7 doktorë shkencash (Dr/PhD), ndërsa pjesa e mbetur (10 PAE) janë personel akademik ndihmës me kualifikimin Msc.

Përsa i takon PAK numri i atyre të cilët kanë grada akademike është si vijon: 4 doktorë shkencash dhe 6 PAK pedagogë me kualifikimin Msc. Përsa i takon raportit PAE/PAK në Fakultetin e Drejtësisë sipas gradave situata paraqitet si vijon: në nivelin profesor PAE 0/PAK 0; në nivelin profesor i asociuar PAE 1/PAK 0; në nivelin doktor shkencash PAE 7/PAK 4; në nivelin pedagogë me kualifikimin Msc PAE 10/PAK 6. Sërish, shihet një numër i lartë i pedagogëve me kualifikimin Msc të angazhuar në këtë program, megjithëse Institucioni arrin të përmbushë kriterin ligjor të pedagogëve PAE me tituj dhe grada.

Në vitin akademik 2017-2018 përbërja e pedagogëve të departamentit në lidhje me gradat dhe numrin paraqitet e ndryshme krahasuar me vitin akademik 2016-2017. Në vitin 2017-2018, numri i përgjithshëm i pedagogëve është ulur lehtësisht nga 28 në 26, respektivisht janë larguar 1 PAE dhe 1 PAK.

Stafi administrativ rezulton të jetë 13 dhe mbulon pozicionet që i takojnë zyrës së sekretarisë (regjistrimit), Financës; Burimet Njerëzore; Arkiva dhe Protokolli; Marrëdhëniet me jashtë dhe të karrierës.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportit PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program për vitin akademik 2018-19, përbëhet nga 29 pedagogë, nga të cilët 18 PAE dhe 11 PAK (Ref. Tab 4 – Cilësia e stafit akademik). Kualifikimi i stafit paraqitet si vijon: **PAE:** 1 Prof. As., 6 Dr. dhe 11 Msc.; **PAK:** 1 Prof. As., 4 Dr., 1 Doc., 1 Doktorant dhe 4 Msc. Personeli akademik është në një nivel të kënaqshëm për sa i takon numrit të pedagogëve në raport me studentët. Kualifikimi i stafit akademik të brendshëm, për sa i përket titujve dhe gradave, paraqitet në nivelin e parashikuar sipas kërkesave ligjore të LAL 80/2015. GVJ konstaton se në vitin akademik 2018-2019, raporti i personelit akademik PAE me studentët është mesatarisht 1/6 (referuar Tabelës 19 të Anekseve rezultojnë 327 studentë aktiv në total).

Stafi akademik i brendshëm rezulton të ketë në ngarkim 1-2 lëndë në këtë program studimi. Evidentohet vetëm një pedagog me 3 lëndë. GVJ konstaton gjithashtu se ka personeli PAE ngarkohet dhe me punë të tjera administrative.

Konstatohet një shpërndarje e mirë e personelit PAE sipas moshës, ku predominon stafi akademik në moshën 25-35 (9 PAE nga 18).

Vihet re një angazhim i lartë i stafit akademik me kualifikimin Msc. si titullarë lëndësh: 6 nga 22 lëndë.

Kriteret e rekrutimit u konstatuan të jenë mjaft rigorozë dhe procedura e hapjes së një vendi të ri origjinohej nga nevojat e mundshme të departamenteve. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik janë në varësi të kërkesës për staf akademik. Preferohen për t'u zgjedhur stafi akademik me grada e tituj.

Procesi i rekrutimit bëhet duke ndjekur procedura publike dhe nga kriteret të përcaktuara qartë në rregulloret e Institucionit dhe mbi një bazë transparente të paraqitjes së kriterëve duke respektuar kështu dispozitat ligjore (shih Rregulloren dhe Procedura e Rekrutimit/Dosja e Plote). Në dokumentacionin e paraqitur janë përcaktuar dy tipologji të veçanta kontratash për personelin PAE dhe PAK. Kjo edhe duke patur parasysh profilet, kërkesat dhe angazhimin e ndryshëm të këtyre dy figurave pranë Institucionit.

Kontratave të pedagogut u bashkëlidhet dhe Aneks Kontrata, e cila reflektonte lëndën, aktivitetin shkencor si dhe detyrimet e tjera administrative.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat (Tabela 5 e Anekseve)

GVJ, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin dhe tabelat përkatëse mbi personelin akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi, sipas Tabelës 5 “*Të dhënat e stafit akademik për programin e studimit sipas kualifikimit*” dhe raportet midis tyre, evidenton si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2018-2019, kualifikimi i stafit paraqitet si vijon:
18 PAE: 1 Prof. As., 6 Dr. dhe 11 Msc.
11 PAK: 1 Prof. As., 5 Dr., 1 Doktorant dhe 4 Msc.
2. Për vitin akademik 2017-2018, kualifikimi i stafit paraqitet si vijon:
17 PAE: 1 Prof. As., 7 Dr dhe 9 Msc.
9 PAK: 5 Dr. dhe 4 Msc.
3. Për vitin akademik 2016-2017, kualifikimi i stafit paraqitet si vijon:
18 PAE: 1 Prof. As., 7 Dr dhe 10 Msc.
10 PAK: 4 Dr., 1 Doktorant dhe 5 Msc.
4. Për vitin akademik 2015-2016, kualifikimi i stafit paraqitet si vijon:
18 PAE: 1 Prof. As, 6 Dr, 2 Doktorant dhe 9 Msc.
9 PAK: 2 Dr., 3 Doktorant dhe 4 Msc.
5. Për vitin akademik 2014-2015, kualifikimi i stafit paraqitet si vijon:

17 PAE: 4 Prof. As, 6 Dr, 2 Doktorant dhe 5 Msc.

10 PAK: 2 Prof. As, 1 Dr, 5 Doktorant dhe 2 Msc.

6. Për vitin akademik 2013-2014, kualifikimi i stafit paraqitet si vijon:

10 PAE: 2 Prof.As, 3 Dr, 5 Msc.

23 PAK: 4 Prof., 5 Dr, 14 Msc.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 6 e Anekseve)

GVJ, pasi u konsultua me evidencat bashkelidhur RVB (Tabela 5), konstaton se përgjithësisht në këtë program studimi ruhet një numër konstant i stafit akademik të brendshëm (17-18). Po ashtu shihet që dhe kualifikimi i tyre qëndron i njëjtë dhe konstant përse i përket cilësisë së stafit të brendshëm të angazhuar në këtë program. Rezulton në të gjitha vitet 1 Prof. As dhe 5-7 Dr, me një ulje të lehtë gjatë vitit akademik 2018-19 përse i përket PAE me gradën Dr. Stafit akademik i jashtëm (PAK) zotëron përgjithësisht kualifikimin Dr, me përjashtim të viteve akademike 2013-14; 2014-15 ku evidentohet angazhimi i personelit me kualifikim Prof. As dhe Prof. Personeli PAK, në tre vitet e fundit qëndron midis 9-10 pedagogë të angazhuar, të cilët vijnë më së shumti nga institucione publike dhe private të fushës.

Raporti PAE dhe PAK rezulton si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2018 – 19, raporti PAE\PAK është 1.6\1
2. Për vitin akademik 2017 – 18, raporti PAE\PAK është 1.9\1
3. Për vitin akademik 2016 – 17, raporti PAE\PAK është 1.8\1.8
4. Për vitin akademik 2015 – 16, raporti PAE\PAK është 2/1
5. Për vitin akademik 2014 – 15, raporti PAE\PAK është 1.7/1
6. Për vitin akademik 2013 – 14, raporti PAE\PAK është 1\2.3
7. Për vitin akademik 2012 – 13, raporti PAE\PAK është 1.\2

Të dhënat sipas seksit

Nga përbërja gjinore u konstatua se stafi mësimdhënës me kohë të plotë për vitin akademik 2018-19 përbëhet nga 11 femra dhe 7 meshkuj, ndërsa stafi mësimdhënës me kontratë përbëhet nga 7 femra dhe 4 meshkuj.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela 7 e Anekseve)

Sipas moshës së personelit të brendshëm konstatohet shpërndarja si më poshtë:

Mosha	25-35	36-45	46-55	56-65	66-68
Stafi	9	4	5	2	2

Sipas moshës së personelit akademik të kontraktuar konstatohet shpërndarja si më poshtë

Mosha	25-35	36-45	46-55	56-65	66-68
Stafi	2	5	2	1	1

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Institucioni ka në funksion të stafit të tij një databazë të plotë të kontratave, të cilat administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Stafit të saporekrutuar u vihej në dispozicion kontratë 1-vjeçare e cila rinovohej automatikisht në kontratë pa afat, pas përfundimit me sukses të periudhës 1 vjeçare të punësimit. GVJ gjatë vizitës në Institucion u konsultua me disa formate kontratash të stafit akademik PAE dhe PAK. Kontratat kishin të përshkruar në mënyrë rigorozë të drejtat dhe detyrimet përkatëse si dhe ishin të mbështetura në aktet rregullative dhe ato të brendshme (Statuti; Rregullore të brendshme, etj). Kontratat ishin të firmosura nga pedagogët e rekrutuar dhe Rektori. Bashkëlidhur kontratave të stafit efektiv të brendshëm ishin dhe Anekset me përshkrimin e detyrave dhe ndarjen e ngarkesës mësimore\shkencore dhe administrative.

- Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës administrativ funksionon në nivel institucioni dhe duke u përshkallëzuar deri në nivel Departamenti. Aktualisht në funksion të programit të studimit rezultojnë 4 staf administrativ të brendshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni ka parashikime të sakta nënligjore për rekrutimin e personelit sipas evidencave në dosjen e vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të konsultuar gjatë vizitës në vend. Kriteret e punësimit janë të qarta dhe të kategorizuara. Nevoja për rekrutim nis nga njësia bazë (Departamenti) dhe miratohet nga Rektori. Dekani i fakultetit, mbi bazën e kërkesës së bërë nga njësia bazë ngre një komision ad hoc me përfaqësues të njësisë bazë për vlerësimin e kandidatëve. Dekani mbi bazën e relacionit dhe vlerësimit të komisionit i prezanton Rektorit, listën e kandidatëve të përzgjedhur dhe listuar.</p> <p>Në fund të procesit Rektori dhe i punësuar i nënshkruajnë Kontratën, sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Kontratës individuale i bashkëlidhet dhe një Aneks, ku përmbahet aktiviteti i mësimdhënies; kërkimit shkencor dhe detyra të tjera administrative (nëse parashikohet). Në aspektin numerik raporti PAE/PAK paraqitet 62 % PAE dhe 38 % PAK, ndërsa përsa i përket ngarkesës së mësimdhënies, personeli akademik me kohë të plotë mbulon 73.4 % . GVJ evidenton se ngarkesa mësimore në auditor për stafin akademik të brendshëm është 1905 orë në total, ndërsa stafi i jashtëm është i angazhuar në 805 orë në total, megjithatë Institucioni sigurohet që ti atribuojë stafit të tij dhe funksione administrative në zyrat si: Marrëdhëniet me jashtë; Zyra e studentit dhe këshillimi i karrierës; NJSBC etj.</p> <p>Institucioni sigurohet të kryejë vlerësime të personelit të tij akademik, 2 herë në vit, përmes pyetësorit të studentëve, vlerësimit <i>ad-hoc</i> të zhvillimit të mësimin nga NJSBC në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit ose Dekanin. Procesi i vlerësimit kryhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ja bën të ditur rezultatet e pyetësorëve, personelit akademik.</p> <p>Dosjet dhe dokumentacioni i stafit akademik administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ndjek proceset e rekrutimit dhe kontratave të stafit akademik</p>

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;

Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;

Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent”

Institucioni, përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore administron databazën e stafit akademik si dhe të dokumentacioneve përkatëse.

Nga vlerësimi në vend u konsultuan disa dosje të stafit akademik nga i cili rezultoi se informacioni ishte i plotë sipas parashikimeve ligjore. Kriteret e punësimit bëhen publike përmes faqes zyrtare ëeb të Institucionit www.luarasi.edu.al.

U konstatua se Institucioni, në këtë program studimi, rekruton më së shumti staf akademik me gradë shkencore e titull akademik. Megjithatë evidentohen lëndë të cilat mbulohen nga staf akademik pa kualifikimin përkatës si: “E drejta penale e posaçme”; “E drejta administrative”, “E drejta romake”, “E drejta ndërkombëtare private”; “Pronësia intelektuale”; “Filozofia e së drejtës”. Institucioni, gjatë vizitës në vend, deklaroi se është në dijeni të këtij fakti dhe se përpiqet të rekrutojë staf të motivuar dhe të aftë për të mbuluar këto lëndë. GVJ e gjykon këtë si një dobësi të Institucionit dhe rekomandon adresimin sa më të shpejtë nga Institucioni.

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;

Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

Institucioni, në përmbushje të misionit të tij, dëshmon qëndrueshmëri dhe angazhim të stafit të tij administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor, sikundër dëshmohet dhe në evidencat e paraqitura në mbështetje të raportit të vetëvlerësimit.

Për realizimin e praktikave profesionale, Institucioni, duke u mbështetur në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucionineve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre” ka caktuar një lektor për ndjekjen e praktikës profesionale, për çdo grup studentësh (25 të tillë).

Lektorët caktohen çdo vit akademik dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Aktualisht në vitin akademik 2018 – 19 janë caktuar 3 lektorë udhëheqës të cilët, janë identifikuar në evidencat përkatëse.

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

Institucioni ka ndërmarrë disa aktivitete në funksion të zhvillimit dhe krijimit të hapësirave për zhvillimin e mëtejshëm të personelit të tij akademik. Këto aktivitete lidhen më së shumti me botimet shkencore, konferenca si dhe pjesëmarrje në aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, institucioni ka ndërmarrë dhe aktivitete trajnuese për “Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies”, të cilat inkurajohen të zgjerohen më tej në funksion të rritjes së cilësisë.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni dëshmon se ka ndjekur me rigorozitet procedurat e rekrutimit dhe administrimin e plot të dosjeve përkatëse.
2. KU "Luarasi" ka ndërmarrë procese të trajnimit të vazhueshëm për stafin e tij të brendshëm, duke identifikuar nevojat përkatëse, në varësi të rezultateve të vlerësimit.
3. Institucioni, ka angazhuar si titullarë lëndësh, pedagogë me kualifikimin "Master i Shkencave" të cilën GVJ e identifikon si nevojë për përmirësim.
4. Në aspektin numerik raporti PAE/PAK paraqitet 62 % PAE dhe 38 % PAK, ndërsa pjesa i përket ngarkesës së mësimdhënies, personeli akademik me kohë të plotë mbulon 73.4 % .

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Kolegji Universitar "Luarasi" ushtron aktivitetin e tij në ambientin e marrë në posedim, për një periudhë 20 vjeçare, mbi objektin ish Konvikti i Shkollës së Gjuhëve të Huaja "Asim Vokshi", Rruga e Elbasanit, Tiranë, me sipërfaqe funksionale prej 2 822 m², sipas kontratës së Qerasë me Nr. 11436 Rep., dhe Nr. 1838 Kol., të datës 29.08.2013. Ambientet janë në sasi të konsiderueshme dhe plotësohen kërkesat teknike për normativën e sipërfaqes. Sipërfaqja totale e objektit (godinë + oborr) është 6.609m² dhe rezultojnë të përshtatshme për akomodimin e numrit aktual të studentëve.

Godina, sipas evidencave të dhëna dhe verifikimit në terren të GVJ, rezultojnë me auditore leksionesh dhe seminaresh, zyra të kompletuara për stafin akademik dhe personelin administrativ, bibliotekë dhe laboratore në funksion të programeve mësimore që ofron Institucioni. Në KU "Luarasi" ndodhet një bibliotekë, me sipërfaqe prej 43 m², e cila akomodon 20 persona.

Biblioteka funksionon çdo ditë nga ora 09:00 – 21.00. Nga informacioni i marrë në RVB dhe evidencës Nr. 11 e sipas informacionit gjatë vizitës në vend, Institucioni ofron bibliotekë on-line sipas platformës "Questia". Kontrata për ofrimin e shërbimit është aktive dhe rinovohet çdo vit. Ky shërbim është në funksion të pedagogëve dhe studentëve. Gjithashtu, sipas evidencës "*Titujt e librave të drejtësisë – Biblioteka KU Luarasi*" të kërkuar gjatë vizitës në vend, Biblioteka ofron një fond prej 351 titujsh të lidhura ngushtësisht me programin e studimit Bsc. në "Drejtësi". Institucioni ka databazën elektronike të titujve të librave dhe është në proces të finalizimit të programit të bibliotekës së brendshme online, për të mundësuar aksesimin e studentëve dhe pedagogëve në fondin e titujve të librave që kjo bibliotekë administron.

Godina ka një laborator (Kabineti i Informatikës), i pajisur me një projektor dhe shërben për të gjithë programet e studimit. Sipas RVB sekretaria mësimore është e pajisur me mobilimin përkatës: tavolina, karrige, kompjutera, printerat. Në të kryhen procedurat administrative, mbahen regjistrat mësimorë, procesverbalet etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga informacioni i dhënë në RVB, treguesit e matshëm për Fakultetin e Drejtësisë, jepen si më poshtë (Tabela 8 e Anekseve):

- | | |
|--|---|
| • Salla për leksione | 5 |
| • Klasa për seminare | 3 |
| • Salla për aktivitete promovuese | 2 |
| • Salla për praktikë lëndore/ profesionale | 1 |

- Laboratorë për lëndët N/A
- Laboratorë informatike 1
- Salla interneti 1
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj. N/A
- Zyrë informacioni për studentët 1
- Nyje hidrosanitare 2

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 2
- Zyra për sekretarinë mësimore 1
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore 3
- Zyra për personelin akademik 4

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka siguruar për studentët e tij Bibliotekën e Institucionit, ku administrojnë rreth 350 tituj librash fizik, në funksion të programit të studimit. Fondi i librave dhe i periodikëve konsiderohet bazik dhe Institucioni inkurajohet të shtojë volumin e titujve duke evidentuar nevojën për pajisjen e bibliotekës me titujt e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar, sipas syllabuseve përkatëse.</p> <p>Institucioni ofron dhe akses në bibliotekën online “Questia” e cila ka rreth 95.000 tituj librash elektronikë në gjuhë të huaj. Orari i ofrimit të bibliotekës është 09:00 – 21:00, çdo ditë të javës.</p> <p>Institucioni kishte ndërmarrë hapa për adresimin e rekomandimit Nr. 3 të Këshillit të Akreditimit, sipas Vendimit Nr. 336, datë 08.06.2012 (<i>Të ndërtohet një bibliotekë elektronike</i>), duke ngritur një grup pune me përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për zhvillimin e programit. Megjithatë, u evidentua se ky sistem nuk është finalizuar dhe institucioni deklaroi në RVB se pritet të përmbyllet gjatë muajit Shkurt, 2019.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Institucioni ka në funksion të programit të studimit ambientë të përshtatshme, duke përfshirë:

1 Bibliotekë;

2 Laboratore (Informatike dhe Kriminalistike);

1 Klinikë Ligjore

9 Auditore, me kapacitet prej 60 – 80 studentësh

11 klasa seminaresh

13 salla pedagogësh, etj.

Ambientet paraqiten të përshtatshme sipas standardeve teknike dhe rezultojnë të mjaftueshme për organizimin cilësor të mësimdhënies. Gjithashtu ato janë të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore (projektor, ëifi, etj) të cilat sigurojnë kushtet e nevojshme për studentët.

Institucioni ka në funksion të studentëve të këtij programi studimi dhe Laboratorin e Kriminalistikës ku kryhen praktika lëndore dhe stimulime të ndryshme.

GVJ konsideron si praktikë të mirë themelimin dhe funksionimin e Klinikës Ligjore, si një mënyrë për të angazhuar studentët e këtij programi në aftësimin profesional, duke ndërthurur dhe kontributin e dhënë përmes asistencës ligjore. Klinika Ligjore ndihmon gjithashtu në realizimin e praktikës profesionale, e cila është lëndë e posaçme e programit mësimor.

Institucioni është i angazhuar përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit për mundësimin e praktikave për studentët e tij.

Konkluzione të GVJ:

1. Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit është e përshtatshme për realizimin me sukses të tij.
2. Ngritja dhe funksionimi i Klinikës Ligjore vlerësohet nga GVJ si një praktikë e mirë e ndërthurjes midis nevojës dhe angazhimit për zhvillimin e praktikës profesionale dhe ofrimin e shërbimit ndaj palëve të treta.
3. GVJ vlerëson angazhimin e Institucionit për ofrimin e librarisë online “Questia”, megjithatë rekomandohet që biblioteka fizike të pasurohet me fonde librash e sidomos periodikëve të fushës.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar "Luarasi" është pjesë përbërëse e shoqërisë "Panorama Grup" sh.a. Menaxhimi financiar i Institucionit bëhet nga Zyra e Financës së Kolegjit Universitar "Luarasi" në bashkëpunim me zyrën e financës së shoqërisë "Panorama Grup" sh.a.

Institucioni financohet nga tarifat e studentëve, pagesat e studentëve për shërbimet administrative dhe nga burime të shoqërisë "Panorama Grup" për disbalancat afatshkurtra të krijuara ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve dhe auditohet çdo vit në mënyrë të rregullt nga një ekspert kontabël i autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Programi i studimit financohet në masën 98.89% nga tarifat e studentëve të saj dhe 1.11% janë të ardhura të tjera.

Institucioni sigurohet të kontrollohet për situatën financiare, çdo vit, duke u audituar nga ekspert kontabël i cili përgatit raportin përkatës dhe depozitohet pranë QKR-së sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) (tabela 9 e Anekseve):

• Grantet për kërkim	-
• Konsulencat, shërbimet	-
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.89%
• Sponsorizimet	-
• Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	-
• Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	-
• Te ardhura te tjera nga veprimtaria	1.11 %

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve shkon për shpenzime që lidhen me kostot e punës. Të dhëna të detajuara paraqiten në tabelën 10 të Anekseve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, realizon çdo vit auditimin përmes ekspertit të jashtëm të licensuar.</p> <p>Eksperti kryen kontroll mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bilancin Kontabël vjetor • Pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve • Pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit • Pasqyrën e flukseve të parasë • Një përmbledhje të politikave kontabël. <p>Raporti i auditit përmban të gjitha detyrimet, pasqyrat financiare sikundër kërkohet në përputhje</p>

	me aktet nënligjore. Raporti i auditit depozitohet gjithashtu në QKR, në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi.
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>KU “Luarasi” dëshmon qëndrueshmëri financiare, të reflektuar në pasqyrat financiare, informacion ky i paraqitur në RVB dhe evidencat bashkëlidhur.</p> <p>Në pasqyrat financiare gjenden të detajuara llogaritë aktive dhe të detyrimeve, pasqyrat analitike të kapitalit, pasqyra e aktiveve dhe amortizim për periudhën përkatëse.</p> <p>Raportet financiare gjenden në Zyrën e Financës të Kolegjit Universitar “Luarasi”.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. KU “Luarasi”, bazuar në kërkesat e ligjit dhe rregulloret e tij të brendshme, ndërmer një auditim të përvitshëm të brendshëm e të jashtëm financiar, të dhënat e të cilit janë transparente e përdoren për të formuluar planet e zhvillimit të ardhshëm institucional. 2. Bazuar në raportin e auditit institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimeve dhe në bazë të të dhënave vendos për strategjinë e zhvillimit afat-mesëm të programit. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Kolegjin Universitar “Luarasi” funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, fillimisht e ngritur si Grupi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në vitin 2007, me urdhër të Rektorit të SHLUJ “Luarasi”e më tej i riorganizuar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas informacionit të paraqitur në RVB dhe evidencave “Manuali i NJSBC” dhe “Strategjia e NJSBC 2016 – 2020”, kjo njësi ka si funksion: Vlerëimin e brendshëm të cilësisë në dy aspekte, vlerësimin e brendshme të programeve të studimit dhe vlerësimin institucional, si dhe kryen procese të tjera vlerësuese dhe monitoruese.

NJSBC është përgjegjëse për organizimin e pyetësorit të studentëve, në fund të çdo semestri akademik apo para sezonit të provimeve. Gjithashtu ajo është e angazhuar në procese të përmirësimit të cilësisë, detyrë të cilën e ushtron përmes hartimit të raporteve ku evidentohen

problematikat, sugjerimet dhe udhëzime të mëtejshme për strukturat e brendshme të institucionit (Evidenca Nr. 28 – Raport i vëzhgimit të procesit mësimor).

Aktualisht, sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr.12/4, datë 23.12.2016 “Për ngritjen e njësisë të brendshme të sigurimit të cilësisë”, NJSBC ka në përbërje të saj 5 anëtarë, nga të cilët 1 ekspert të jashtme dhe 1 student. (Tabela 11 e Anekseve)

Gjatë vizitës të kryer në institucion u kërkua informacion i mëtejshëm për rolin, përzgjedhjen dhe funksionet e ekspertit të jashtëm, për të cilën KU “Luarasi” deklaroi se nuk ka një kontratë angazhimi por Senati Akademik e ka miratuar si të tillë.

NJSBC kujdeset gjithashtu në mbledhjen e të dhënave statistikore, të akumuluar në proceset e anketimit të studentëve dhe ja bën të ditur Rektorit.

Gjatë shqyrtimit të RVB rezulton së NJSBC zotëron autonomi operative, megjithatë, nuk përcaktohet saktësisht përkufizimi i strukturës së NJSBC-së, nëse ajo është konceptuar si njësi administrative apo akademike, me funksione ad-hoc apo e përhershme. Sipas Statutit të KU “Luarasi”, Neni 74, pika 1 citohet: “1. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) është një strukturë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore, kërkimore-shkencore, që i raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë rektorit...” dhe gjithashtu në Organigramën e Institucionit (tabela 1 e Anekseve) kjo njësi deklarohet si “Zyra e NJSBC” në varësi të Rektorit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit:

1. Realizohen 2 (dy) anketime në vit për studentët në të gjitha ciklet e studimit;
2. Anketimi bëhet online dhe ftohen të gjithë studentët për ta plotësuar (aktualisht studentët e plotësojnë anketimin në Laboratorin e Informatikës në Institucion);
3. Rezultatet e anketimeve nuk kane nxjerrë problematika të veçanta dhe shqetësuese. Nga vizita e GVJ deklarohet vetëm një problematikë e cila lidhet me një aspekt teknik të metodologjisë së mësimdhënies nga një lektor, problematikë e cila është evidentuar dhe adresuar.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë:

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e ushtron veprimtarinë e saj sipas dispozitave të Statutit të KU “Luarasi”, Rregullores së KU “Luarasi” dhe “Manualit të sigurimit të cilësisë”. NJSBC rezulton ti raportojë Rektorit në mënyrë të drejtëpërdrejtë për rezultatet e anketimeve si dhe u jep pedagogëve përkatës rezultatet në mënyrë konfidenciale. Njësia ka përdorur dhe instrumenta të tjera për kontrollin e cilësisë si p.sh: vëzhgime të paparalajmëruara në auditor në kuadër të metodologjisë së mësimdhënies, si dhe ka identifikuar disa nevoja për trajnim të stafit akademik, në funksion të misionit sugjerues që kjo njësi ka të parashikuar (2 trajnime për metodologjinë e mësimdhënies). Njësia gjithashtu koordinon dhe bashkëpunon me institucionet e sigurimit të jashtëm të cilësisë në kuadër të proceseve të akreditimit të programeve të studimeve dhe ato institucionale. Ajo rakordon dhe koordinon punën me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për shkëmbimin e të dhënave dhe raportimeve.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti:

Sipas RVB garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë nuk është vetëm detyrë e NJBSC, por e rëndësishme është të krijohet dhe zhvillohet kultura e cilësisë në cdo qelizë të funksionimit akademik dhe administrativ të KU “Luarasi”. Ngritja e GVB pranë Fakulteteve, përfshirja në to edhe e studentëve i shërben pikërisht këtij synimi. NJBSC monitoron dhe menaxhon profesionalisht cilësinë duke bashkëpunuar me GVB e fakulteteve. E rëndësishme është gjithëpërfshirja e palëve të

interesuar në garantimin dhe rritjen e cilësisë. Sipas takimit me NJBCS, u konstatua se monitorimi dhe menaxhimi i cilësisë shkonte deri në nivel departamenti.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre:

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga NJSBC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj. GVJ u njoh me rezultatet e vetëvlerësimeve për vitin akademik 2017-2018.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike:

Njësia, përmes raportit vjetor që i përcillet Rektorit, ka bërë një panoramë të përmbledhur sipas anketimeve të studentëve. Nuk evidentohen raste të skicimit apo reformimit të politikave të cilësisë, mbi bazën e vetëvlerësimit, megjithatë në RVB deklarohet se NJSBC do të shtrijë veprimtarinë e saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; 	<p>Kolegji Universitar “Luarasi” ka në strukturën e tij Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si njësi e përhershme. Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të NJSBC dhe referuar evidencave, rezultoi se kjo njësi ka në përbërje të saj personel akademik, si dhe 1 ekspert të jashtëm dhe 1 Student.</p> <p>GVJ, bazuar në aktet ligjore në fuqi, rekomandon definim më të saktë të strukturës ligjore të kësaj Njësie, për të konkretizuar kështu funksionet e parashikuara dhe ndarjen më të plotë të detyrave midis anëtarëve të saj.</p> <p>Gjithashtu, rekomandohet që eksperti i jashtëm, anëtar i NJSBC, ti vihet në dispozicion Kontratë Shërbimi për të formalizuar marrëdhënien me NJSBC-në.</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit. Për këtë qëllim është ngritur NJBSC, e cila është përgjegjëse për vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të marrë në institucion, GVJ konstaton se institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke ia bërë të ditur palëve të interesuara.</p> <p>Institucioni informon palët e interesuara (drejtuesit e institucionit, të njësive kryesore dhe bazë dhe</p>

<p>provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>pedagogët) për rezultatet e vlerësimit.</p> <p>GVJ, në bazë të RVB dhe evidencave ka identifikuar disa metoda vlerësimi, të aplikuara nga KU "Luarasi":</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Metoda të tërthorta për vlerësim si: pyetësorë të studentëve, të të diplomuarve, intervista, raporte të vlerësimit të mësimdhënies, etj. 2. Metoda të drejtpërdrejta si: dëgjime në auditor të paralajmëruara, rezultatet e arritura nga studentët në testime, provime dhe detyra kursi, vëzhgime të kryerjes së praktikës/ushtrimeve etj. <p>GVJ konstaton se Institucioni i bën publike rezultatet e pergjithshme të vetëvlerësimit përmes raporteve periodike.</p>
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p> <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>KU "Kuarasi" është i akredituar Institucionalisht me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 115, dt. 15.12.2017, me vlefshmëri 6 vite.</p> <p>NJSBC në KU "Luarasi" është relativisht e re, ritheluar rishtazi sipas vendimit të Senatit Nr. 12/4, datë 23.12.2016, megjithatë evidentohet se nismat si hartimi i "Strategjisë së sigurimit të cilësisë 2016-2020" janë një gur themeli i nevojshëm për funksionimin dhe ngritjen e kulturës së cilësisë në Institucion për arritjen e objektivave.</p> <p>GVJ konstaton se NJSBC është e përfshirë në disa procese vlerësimi, si në aspektin formal ashtu dhe përmbajtësor, duke përmendur: Vlerësimin e komponentëve të syllabuseve; Vlerësimin e marrëveshjeve që KU "Luarasi" nënshkruan me institucione të tjera; Vlerësimin e nevojës së lektorëve për trajnime të ndryshme, etj.</p> <p>NJSBC gjithashtu dëshmon se ka zhvilluar aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e kulturës së cilësisë dhe proceseve që e shoqërojnë, megjithatë duhet të mundësohen dhe procese të tjera të vetëvlerësimit si psh. peer to peer review, vlerësimi i pedagogëve për programet mësimore/ infrastrukturës/ autoriteteve drejtuese, etj.</p> <p>GVJ, duke vlerësuar arritjet e deritanishme të NJSBC, rekomandon dhe parashikimin e dispozitave për ndjekjen e rekomandimeve si rezultat i raporteve që NJSBC prodhon (folloë – up).</p>




Konkluzionet e vlerësimit:

1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka një politikë të qartë të funksionimit të saj dhe GVJ identifikon praktika të mira për funksionimin më efikas dhe ngritjen e kulturës së cilësisë në Institucion.
2. GVJ vlerëson strategjinë institucionale të hartuar për vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe rekomandon përcaktimin e procedurave të folloë-up për ndjekjen e zbatueshmërisë së planeve.
3. NJSBC të definojë me saktë funksionet e saj si njësi administrative me detyra të qarta dhe përshkrime pune për të gjithë anëtarët e saj.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi i studimit Bachelor në Drejtësi, pranë KU "Luarasi", është ndërtuar dhe konceptuar brenda qëllimit dhe misionit akademik të formimit të juristit/profesionistit. Realizimi i objektivit të këtij programi studimi përmbushet përmes përmbajtjes së kurrikulës dhe elementeve përmbajtësore të syllabuseve. Elementet e çdo plan-programi lëndë/moduli janë në harmoni me qëllimin e kurrikulës duke evidentuar qartësisht objektivat e lëndës/modulit; përmbajtjen e temave që do të zhvillohen përgjatë lëndës/modulit; elementët e kontrollit të dijes dhe literaturën përkatëse. Përmbajtja e çdo lëndë/moduli i bëhet e njohur studentëve në orën e parë të prazantimit të lëndës. Studentët janë të informuar dhe ndihen pjesëmarrës në zhvillimin dhe respektimin e të gjithë komponentëve të lëndës/modulit.

Mbështetur në RVB, ekspertët e vlerësimit shprehen se: Misioni i UNYT është përgatitja e udhëheqësve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të të nxënit dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar. Ky program u ndërtua me idenë e tërheqjes së një segmenti tregu i cili kishte nevojë për një mësimdhënie dhe program nga i njëjti institucion por në gjuhën shqipe.

Ky program studimi rregullohet nëpërmjet rregullores së posaçme të këtij programi të miratuar nga Fakulteti i Drejtësisë (*Aneks 12: Rregullore e Programit Bachelor në "Drejtësi"*) si dhe nga Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë (Evidenca 9). Ky program studimi mbulohet nga stafi akademik i të tre departamenteve (Publik, Civil dhe Penal) dhe është në përputhje me standardet që kërkohen për një program të ciklit të parë. Programi është i organizuar në tre vite akademike me 180 ECTS dhe në të ofrohen lëndë të disiplinave karakterizuese të programit si dhe të disiplinave të përafërta, të cilat mundësojnë ofrimin e dijeve të nevojshme dhe të mjaftueshme për një program të tillë. Programi është i organizuar në orë që zhvillohen në auditor dhe të cilat në raport më peshën e orëve jashtë auditorit janë në masën 40% duke mundësuar një numër orësh të mjaftueshme për punë të pavarur të studentëve, ndërsa numri i krediteve të lëndëve që zhvillohen në auditor dhe jashtë auditorit në raport me ato që zhvillohen vetëm si punë e pavarur është në raportin 96 % (173 ECTS)/4% (7 ECTS punimi i diplomës ose provimi përfundimtar). Meqenëse ky është një program

studimi në ciklin e parë raportet e mësipërme janë brenda parametrave akademike për programe të tilla (të dhënat dhe llogaritjet e më sipërme GVJ i ka bërë duke u nisur nga të dhënat sasiore që gjenden në kurrikul).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” si një program studimi 3 vjeçar (me 180 ECTS) ka filluar në vitin akademik 2010-2011 me Urdhërin Nr. 324, datë 21.06.2010 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si rezultat i ndryshimit të programit të studimit në “Drejtësi” me kohezgjatje 4 vjeçare (240 ECTS) i hapur në vitin 2003 (themeluar me VKM Nr.611, datë 11.09.2003). Me Urdhërin Nr. 271, datë 29.06.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është akredituar programi i studimit Bachelor në “Drejtësi”, për një periudhë gjashtë vjeçare.

Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Luarasi” zhvillohet në tre vite akademike të ndara në gjashtë semestra (dy semestra për çdo vit akademik).

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë, etj.)

Programi i studimit Bachelor në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Luarasi” sipas viteve akademike dhe organizimit semestral është si më poshtë:

- 1 vit akademik është i organizuar me 30 javë mësimore në auditor (60 ECTS)
- 1 Semestër me 15 javë mësimore në auditor (30 ECTS)
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 50'

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor apo kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Luarasi” e ndarë në vite akademike, ndarja në sistemin e krediteve ECTS, sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë, gjendet në Tabelat 12 dhe 13 të Anekseve të Raportit.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit në programin e studimit “Bachelor” në Drejtësi në Kolegjin Universitar “Luarasi”:

- Leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 14 e Anekseve)

Ndryshimet në planet mësimore lidhen me ndryshimin e numrit të krediteve në disa prej lëndëve, në heqjen nga kurrikula e disa prej lëndëve duke i kaluar ato në programe të tjera studimi (sipas shënimeve që gjenden në tabelat përkatëse në RVB), në zëvendësimin e disa lëndëve me zgjedhje. Më poshte gjenden të dhënat në lidhje me sa më sipër:

Ndryshimet në numrin e krediteve në lëndët: “Historia e Institucioneve dhe Historia e Shtetit dhe së drejtës në Shqipëri” nga 8 ECTS bëhet 10 ECTS; “E Drejta Romake” me 6 ECTS kalon në vitin e dytë akademik; “E drejta Kushtetuese” nga 8 ECTS bëhet 10 ECTS; “Anglisht” nga 6 ECTS

bëhet 8 ECTS; “Hyrje në Kriminialistikë me 4 ECTS kalon në një program tjetër studimi; “E drejta Familjare” nga 8 ECTS bëhet 10 ECTS; “Procedura Civile” nga 8 ECTS bëhet 10 ECTS; “Procedura Penale” nga 8 ECTS bëhet 10 ECTS; “Hyrje në të Drejtën Europiane me 6 ECTS kalon në një program tjetër studimi; “E drejtë Biznesi” me me 8 ECTS kalon në një program tjetër studimi; “E drejta Nërkombëtare Publike” nga 6 ECTS bëhet 6 ECTS; “E drejta Ndërkombëtare private” nga 6 ECTS bëhet 8 ECTS; “Filozofi e së drejtës” nga 6 ECTS bëhet 8 ECTS; “Ekonomia për Juristët” me 4 ECTS hiqet nga programi; praktika Mësimore nga 4 ECTS bëhet 6 ECTS; Mikroteza nga 5 ECTS bëhet “Provimi Përfundimtar” me 7 ECTS (këto të dhëna janë duke u bazuar në RVB dhe në dokumentacionin që institucioni ka vënë në dispozicion).

Bazuar në Vendimin Nr. 5 datë 21.04.2017 të Dekanatit të Fakultetit të Drejtësisë (i diskutuar në mbledhjen përkatëse), të nxjerrë në bazë të propozimit të departamentit të së drejtës Private dhe Publike, Senati Akademik me Vendimin Nr. 10, datë 03.05.2017, ka miratuar ndryshimin në planin mësimor për vitin akademik 2017-2018 (dokumentacioni i sipërcituar u vu në dispozicion të GVJ gjatë vizitës në institucion; ky dokumentacion është i aksesueshëm online në portalin përkatës nga GVJ).

Ky ndryshim lidhet me hyrjen e lëndës “Klinika Ligjore” (6 ECTS), duke e zëvendësuar këtë lëndë me zgjedhje me një lëndë tjetër me zgjedhje “Organizatrat Jofitimprurëse” (6 ECTS).

Ky ndryshim i programit mësimor është i argumentuar në vendimet përkatëse. Argumentat lidhen me kërkesat e tregut të punës për profesionistë të pajisur me njohuri të mirëfillta praktike. Një argument tjetër mbështetës lidhet me punën pozitive dhe të kënaqshme të stafit akademik dhe studentëve nga projekti “Klinika Ligjore Luarasi”.

Nga takimi që GVJ pati me stafin akademik dhe studentët gjatë ditëve të vizitës në institucion konstatoi që studentët ndiheshin më të motivuar për të dhënë rezultate të prekshme në lidhje me angazhimin e tyre në problematikën që vijnë nga praktika e përditshme juridike. Ata mendojnë që kjo lëndë përmbushte pritshmëritë e tyre.

Të gjitha ndryshimet kanë çuar në përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulës së këtij programi studimi Bachelor në “Drejtësi” dhe në mirëplotësimin e komponentit mësimor në auditor dhe jashtë auditorit.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Planet mësimore të programit të studimit “Bachelor” në Drejtësi në Kolegjin Universitar “Luarasi”, të lidhura me personelin akademik përkatës, gjenden në Tabelën 15 të Anekseve.

Programi i studimit të ciklit të parë në “Drejtësi” në Fakultetin e Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Luarasi” zhvillohet me 180 kredite (ECTS) (ky program studimi është hapur në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003 dhe është akredituar me Urdhër Nr. 271, datë 29.06.2012 të Ministrisë Arsimit dhe Shkencës). Programi i studimit zhvillohet në dy semestra në vit dhe ka gjithsej 6 semestra. Në këtë program studimi “Bachelor”, të gjitha lëndët/modulet janë me kreditet përkatëse (ECTS), duke siguruar dhe një shpërndarje të orëve në orë në auditor dhe orë për studim individual të studentit.

Në këtë program studimi “Bachelor”, vlerësimi i lëndëve/moduleve realizohet sipas komponenteve në (Tabela 17 e Anekseve):

- frekuentimi dhe aktivizimi gjatë leksioneve dhe seminareve në masën 10 %. Ky lloj vlerësimi realizon matjen e performancës së studentit përgjatë të gjithë kohës së zhvillimit të lëndës.
- realizimin e detyrimeve të përcaktuara në syllabusin e lëndëve, përkatësisht në formën e eseve, detyrave të kursit, prezantimeve, etj.
- vlerësimin nëpërmjet provimit përfundimtar të lëndës/modulit në masën 50 %.

Vlerësimi përfundimtar i studentit llogaritet si një shumator i pikëve të grumbulluara në të tre vlerësimet e mësipërme. Ky pikësim konvertohet më pas në vlerësimin me notë (të përcaktuar në rregulloren e programit). Sipas nenit 48 të “Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë (Evidenca nr.9),

kontrolli i dijeve bëhet: me shkrim; me gojë; ose me prezantimin e projektit apo detyrës. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit të Drejtësisë. Në lidhje me formimin akademik dhe titujt apo gradat shkencore që stafi akademik ka të lidhura këto me lëndët që ata japin, GVJ konstaton që: në shumicën e lëndëve të këtij programi studimi, stafi ka eksperiencën e duhur akademike dhe përvojën e duhur praktike që në disa prej lëndëve të kurrikulës është e domosdoshme (psh. në lëndë të tilla si: E drejta administrative; E drejta e detyrimeve; E drejta familjare; E drejta penale; E drejta civile; Historia e shtetit shqiptar dhe së drejtës në Shqipëri...etj). Në disa prej lëndëve të kësaj kurrikule, stafi akademik në statusin e lektorit nuk ka përvojën e duhur akademike (të formalizuar në tituj akademik) edhe pse kjo është e mirëkuptueshme, pasi pjesë e stafit akademik mund të jenë edhe pedagogët pa këtë lloj përvojë akademike, të cilët mbështeten dhe asistohen akademikisht nga stafi tjetër i brendshëm. Ndërmjet anëtarëve të stafit akademik GVJ konstatoi një frymë bashkëpunimi akademik.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit e shprehur në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset për çdo lëndë janë të paraqitura si evidenca nga institucioni. Çdo syllabus përmban elementet e kërkuara sipas standardeve dhe modelit të VKM-së përkatëse. Përmbajtja e tyre pasurohet çdo vit akademik nga titullari i lëndës duke u nisur nga ndryshimet që fusha të caktuara të jurisprudencës ndodhin (*kjo u konstatua nga GVJ gjatë takimit me stafin akademik në institucion*).

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga analiza e syllabuseve dhe materiali i vënë në dispozicion të GVJ gjatë vizitës në institucion (*dokumenti që tregon literaturën e aksesueshme në bibliotekën e këtij institucioni për çdo lëndë të programit të studimit*), në lidhje me literaturën bazë dhe ndihmëse për programin e studimit Bachelor në “Drejtesi” në Kolegjin Universitar “Luarasi”, mund të arrijmë në përfundimin që:

- Literatura për çdo lëndë/modul është parashikuar në syllabusin përkatës në varësi të tematikave që parashikohen të trajtohen përgjatë semestrit nga ana e pedagogut përkatës.
- Literatura përditësohet për çdo vit akademik, në varësi të ndryshimeve ligjore.
- Studentët e aksesojnë lehtësisht literaturën e përshkruar në syllabuset e çdo lënde/moduli
- Literatura mund dhe duhet të pasurohet dhe me adresat elektronike ku ky institucion është i regjistruar, për ta bërë më të përdorshme për studentët bibliotekën online.

Në lidhje me përmbajtjen në tërësi të kurrikulës së këtij programi studimi Bachelor në “Drejtesi” GVJ konstaton:

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina të formimit të përgjithshëm (A): ofrohen katër lëndë me 35 ECTS në total, duke zënë rreth 19% të totalit të krediteve. Pështja e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standardeve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina të formimit kategorizues të këtij programi të studimi (B): janë 13 lëndë me 96 ECTS, duke zënë rreth 53% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standardeve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina të ngjashme apo integruese të këtij programi studimi (C): janë 2 lëndë me 16 ECTS, duke zënë rreth 9% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standardeve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina me zgjedhje të këtij programi studimi (D): janë 3 lëndë me 13 ECTS, duke zënë rreth 7% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standardeve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina plotësuese të këtij programi studimi (E): janë 2 lëndë me 14 ECTS, duke zënë rreth 8% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standardeve.

Praktika mësimore është një lëndë e detyrueshme dhe GVJ e konsideron si element mjaft të mirë të procesit mësimor. Praktika realizohet si një lëndë me orë mësimore në auditor dhe në institucion (6 ECTS/60 orë në auditor dhe 90 orë jashtë auditorit). Nga takimi me studentët në institucion, si dhe me strukturat përkatëse që mbështesin këtë lëndë, GVJ konstaton se ky komponent akademik dhe praktik realizohet mjaft mirë.

Sipas akteve ligjore të KU "Luarasi", praktika është lëndë e detyrueshme për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve (pika 5 e "Udhëzuesit të praktikës", evidenca 18). Studenti nuk mund të diplomohet (por mund të dorëzojë diplomën) pa kryer detyrimin e praktikës. Praktika për studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Drejtësi ka 6 kredite. Orët në auditor zhvillohen nga pedagogë të KU "Luarasi", nga profesionistë të fushës si dhe nga kompani të profilizuara në punësim në bashkëpunim me pedagogë të KU "Luarasi" dhe nën përgjegjësinë e këtyre të fundit. Orët në auditor planifikohen dhe koordinohen në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave (pika 8 e udhëzuesit). Dosja e praktikës përmban: 1. Vlerësimin e pedagogut që ka zhvilluar orët në auditor dhe materialet e vlerësuara (CV, letër motivimi, etj). 2. Formularin e miratimit të praktikës. 3. Raportin përfundimtar të praktikës (dosja e studentit) 4. Materiale të tjera shtesë që mund të ketë dorëzuar studentit. Dosjet e praktikës i dorëzohen pedagogut mbikqyrës dhe ruhen pranë Fakulteteve përkatëse.

Për studentët që do të bëjnë temë diplome në fund të studimeve, është "Udhëzuesi për përgatitjen e punimit të diplomës" (evidenca 19). Sipas këtij udhëzuesi orët e këshillimit metodologjik janë orë në auditor, të cilat konsiderohen formalisht si orë seminaresh, që kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Ato nuk duhen ngatërruar me lëndët me natyrë metodologjike që janë parashikuar në secilin program studimi. Studenti/ja është i/e detyruar të ndjekë orët e këshillimit metodologjik të udhëheqësit të diplomës. Ai/a jo duhet të konsultohet herë pas here me udhëheqësin sipas orareve të përcaktuara.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vendimin Nr.5 datë 21.04.2017 i Dekanatit të Fakultetit të Drejtësisë (i diskutuar në mbledhjen përkatëse), bazuar në propozimit e departamentit të së drejtës Private dhe Publike për ndryshimin në kurrikulën e programit "Bachelor" në "Drejtësi";

Vendimi i Senatit Akademi Nr.10, datë 03.05.2017, për miratimin e ndryshimit në planin mësimor për vitin akademik 2017-2018

Dokumenti që tregon literaturën e aksesueshme në bibliotikën e këtij institucioni për çdo lëndë të programit të studimit "Bachelor" në "Drejtësi".

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
---------------------	-------------------------

I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA

Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

Programi i studimit Bachelor në "Drejtësi" ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë i KU "Luarasi". Ky program studimi është i akredituar me Urdhërin Nr. 271, datë 29.06.2012, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës "Për akreditimin e programeve të studimit "Bachelor" në "Drejtësi".

Struktura e vitit akademik është e përbërë me dy semestra dhe çdo vit akademik ka gjithsej 60 ECTS. Programi i studimit garanton ndjekjen e studimeve me kohë të plotë duke realizuar në përfundim të tij me 180 ECTS.

Në përfundim të këtij programi studimi, studentët janë të pajisur me njohuritë teorike dhe praktike në fushën e së drejtës, duke mundësuar në këtë rast dhe përmbushjen e misionit të këtij programi. Për realizimin e plotë të qëllimit dhe objektivit të programit për përgatitjen e juristëve në fushën e së drejtës publike dhe private, në këtë program studimi ofrohen lëndë/module me numrin e nevojshëm të krediteve që realizohen brenda dhe jashtë auditorit në monitorimin e stafit akademik.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Programi i studimit Bachelor në "Drejtësi" është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë, i cili përbëhet nga tre departamente: departamenti i së drejtës publike; departamenti i së drejtës private dhe departamenti i së drejtës penale.

Këto njësi bashkërendojnë me njëra-tjetrën, në lidhje me ofrimin e lëndëve/moduleve që janë pjesë e kurrikulës së programit të studimit "Bachelor". Staf i akademik i këtyre departamenteve bashkërendon punën, në lidhje me harmonizimin e strukturës përbërëse të secilit prej plan-programeve të lëndëve, duke ofruar njohuri teorike dhe praktike të përshtatshme për këtë program studimi.

Informacioni në lidhje me përmbajtjen e kurrikulës së këtij programi studimi i bëhet i ditur studentëve në fazën e regjistrimit dhe për çdo lëndë/modul të programit në fillim të zhvillimit të tyre. Studentët njihen me përmbajtjen e çdo lënde/moduli nga ana e pedagogut/ëve përkatës, të cilët bëjnë të njohur komponentët vlerësues; peshën e çdo komponenti vlerësues; kohën e zhvillimit të provimeve të pjesshme apo dorëzimit të detyrave të kursit, duke bërë të njohur dhe literaturën që do të përdoret nga ana e studentëve për përgatitjen e tyre. Materialet didaktike që pedagogët përdorin në auditor ju vihen në dispozicion studentëve përmes adresës së tyre

elektronike. Struktura e orëve në auditor dhe jashtë auditorit është një element tjetër i syllabusit për të cilën ata informohen.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Përmbushja e misionit të këtij programi studimi për përgatitjen e juristëve në fushën e së drejtës publike dhe private, mundësohet përmes përmbajtjes së lëndëve/module, të cilat kanë ngarkesën e duhur akademike në kredite. Shpërndarja e kësaj ngarkese është e ndryshme në lëndë/module që zhvillohen përgjatë tre viteve akademike. Kjo ngarkesë i korrespondon peshës dhe rëndësisë akademike të lëndës në formimin teorik dhe praktik të studentëve.
2. Të tre njësitë bazë të Fakultetit të Drejtësisë bashkërendojnë me njëra-tjetrën punën për realizimin e procesit mësimor, në lidhje me ofrimin e lëndëve/moduleve që janë pjesë e kurrikulës së programit të studimit “Bachelor”, si dhe, në lidhje me informacionin e nevojshëm akademik që studentëve iu nevojitet për të përmbushur detyrimet e tyre.
3. Informacioni në lidhje me përmbajtjen e kurrikulës së këtij program studimi (si dhe për çdo komponent të plan-programeve të lëndëve/moduleve), i bëhet i ditur studentëve në fazën e regjistrimit dhe në fillim të zhvillimit të çdo semestri ata njihen dhe me përmbajtjen më të detajuar të lëndëve përkatëse.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” në KU “Luarasi” realizohet nëpërmjet formave klasike të dhënies së dijeve: leksioneve dhe seminareve në auditor; detyrave të kursit që studenti i realizon jashtë auditorit dhe praktikave tek ato lëndë që kanë më shumë karakter praktik (Klinika Ligjore). Të gjitha këto forma të mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve janë të parashikuara në programin mësimor të çdo moduli/lënde.

Ky program studimi “Bachelor” realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe përgjatë 6 semestrave në 3 vite akademike. Numri i krediteve për çdo lëndë/modul varion nga 3 ECTS në 10. Janë gjithsej 22 lëndë/disiplina (përfshirë dhe praktikën mësimore (6 ECTS) si dhe provimin përfundimtar (7 ECTS).

Forma e kontrollit të njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet provimeve që në numrin më të madh të lëndëve/moduleve janë me shkrim. Në syllabusin e çdo lënde është përcaktuar forma e kontrollit përfundimtar të dijeve. Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga pesë e lart janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati kthehet detyrimisht në notë. Sistemi i vlerësimit me pikë përfshin pikët e vlerësimit gjatë semestrit për të gjithë lëndën (sipas komponentëve të përcaktuar në syllabus) dhe konvertimin në nota nga 1 në 10 e përcaktuar dhe në Rregulloren e KU “Luarasi”.

Vlerësimi i studentëve për praktikën mësimore (lëndë me 6 ECTS) bëhet nga një komision vlerësues i cili ngrihet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga pedagogët që kanë mbikëqyrur studentin gjatë praktikës, një ose dy pedagogë të tjerë nga departamenti, një përfaqësues nga Zyra e Kurrikulës (opsionale). Praktika vlerësohet me notë. Elementët përbërës të vlerësimit për studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimit: 1. orët në auditor

20% të notës 2. Mbrojtja e praktikës së bashku me dokumentacionin përkatës 80% të notës (sipas “Udhëzuesit për zhvillimin e lëndës së praktikës”, evidencë 18).

Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” në KU “Luarasi” ka gjithsej 4500 orë, nga të cilat reth 1185 orë leksione, 835 orë seminare (ku përfshihen edhe orët e praktikës mësimore dhe për përgatitjen e provimit përfundimtar) dhe 2605 orë studimi individual.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 16 e Anekseve):

- Leksione **1185**
- Seminare **710**
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale **60**
- Teza e diplomës **65**
- Orë për punë individuale **2605**

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 17 e Anekseve):

Forma e kontrollit të dijeve është e specifikuar në çdo syllabus të lëndës/modulit dhe ajo përbëhet nga këto komponentë:

- ✓ Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në masën 10%
- ✓ Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, testime të ndërmjetme etj) nga 20% deri në 40%
- ✓ Provimi përfundimtar 50 % (në të gjitha lëndët/modulet)

Jo në të gjitha lëndët pesha e secilit komponent është e njëjtë, pasi kjo varet dhe nga qëllimi i lëndës/modulit përkatës. GVJ evidenton disa lëndë në lidhje me këtë formë të vlerësimit të dijeve si p.sh. “Klinika Ligjore”, në të cilën 20% e peshës së vlerësimit total e zënë takimet në formën e leksioneve ose seminareve dhe detyrat e ngarkuara për çdo orë në auditor; 30% të peshës së vlerësimit total e zë hartimi i detyrave të realizuara jashtë auditorit në lidhje me çështjet e ngarkuara nga pedagogu dhe 50% provimi përfundimtar (në formën me shkrim).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj. (Tabela 18 e Anekseve)

Sipas dokumentacionit që grupit të vlerësimit të jashtëm iu vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion nga zyrat përkatëse:

Aktivitete të Këshillit Studentor gjatë vitit akademik 2017-2018:

- Konferenca studentore: 2
- Leksione të hapura me pedagogë të huaj dhe vendas, me fokus në temat e aktualitetit: 13
- Forum/klubi i debatit: 12 takime
- Klubi Justicia: 10 takime

Në lidhje me projektet shkencore në rang departamenti, nga raporti i vlerësimit të brendshëm raportohet realizimi nga ana e qendrës së kërkimit shkencor projekti me temë “Revolucioni Kurrikular, një sfidë globale” në bashkëpunim me IISI dhe Soros Foundation.

Ndërsa për projekte shkencore në rang Fakulteti nga RVB del që janë realizuar: projekt me OFSA dhe në partnership ka ngritur Klinikën Ligjore “Luarasi” (20 studentë); Trajnimi “Standardet e procesit të rregullt ligjor si kusht në funksionimin e shtetit të së drejtës”, Qershor 2018 (25 studentë); Forum ekonomik studentor LUARASI “Taksimi një çështje për mbarëvajtjen kombetare”, Qershor 2018; Trajnim “Arsyeto, negoco, fillo”- Youth Alliance for development”, Janar 2015; Trajnim “Praktikë, plotësim i njohurive teorike të studentëve”, me Qendrën

Profesionale IRISOFT, Prill 2015; Konferenca Studentore "Një Analizë për Buxhetin e Shqipërisë", 22 Dhjetor 2016; Konkurs "Sikur të ishim Bankier?", ku KU "Luarasi" u përfaqësua nga 5 studentë të Fakultetit Ekonomik nën udhëheqjen e Pedagogut Leonard Boduri, 28 Mars 2017; KU Luarasi organizoi Forumin Ekonomik "Liderët e Rinj në Biznes", me pjesëmarrjen e sipërmarrësve të rinj të suksesshëm dhe instancat mbështetëse të biznesit, 20 Prill 2017; Ëorkshop "Youth and Democracy in Albania", 6 Qershor 2017.

GVJ evidenton si një ndër projektet më të rëndësishme për kurrikulën e këtij cikli studimesh, Projektin me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (Soros) për ngritjen e Klinikës Ligjore "Luarasi". Përmes projektit të Klinikës së Ligjit, mundësohet simulimi i proceseve gjyqësore, ku studentët të mësojnë mënyrën se si procedohet në procese penale, civile dhe administrative. Studentët përfshihen në mënyrën si procedohet në një proces gjyqësor. Lënda "Klinika Ligjore" është dizenuar në këtë program studimi, duke u bazuar në përvojën e arritur nga ky projekt bashkëpunues.

Ndërsa për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë, nga RVB del realizimi i projektit ndërkombëtar kërkimor në bashkëpunim me Universitetin e Pavia-s, me fokus "Mbrojtja shumë-nivelëshe e së Drejtës për Sigurinë Ushqimore; instrumenta kombëtare dhe ndërkombëtare për luftimin e mashtrimeve ushqimore dhe impaktin mbi territor".

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Kalendari i aktiviteteve të zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (viti akademik 2017-2018)
- Kontratë granti (numër 8237) për zbatimin e projektit "Klinika ligjore Luarasi 2018"

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedura e pranimit të studentëve në Kolegjin Universitar "Luarasi" për këtë program studimi "Bachelor" në Drejtësi, bazohet tek numri i kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara më pas nga Senati Akdemik (në bazë të standardeve të miratuara nga ligjet në fuqi, në lidhje me infrastrukturën dhe kapacitetet e stafit akademik efektiv). Të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë të gjithë shtetasit shqiptarë të cilët zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në VKM-në përkatëse. Në bazë të Statutit të KU "Luarasi", njësia kryesore në bazë të propozimeve të njësive bazë, për çdo vit akademik, në përputhje dhe me kapacitetet akademike dhe infrastrukture, propozojnë numrin e studentëve, për këtë program studimi, si dhe kriteret e pranimit të studentëve (evidencë 6). Përzgjedhja e studentëve fitues miratohet nga drejtuesit e njësive kryesore, sipas procedurës së përcaktuar në rregullore. Kriteret shtesë të pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve shpallen publikisht çdo vit dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Kriteret specifike hyrëse në këtë program studimi:

- Vërtetimi me dokument zyrtar i përfundimit të shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- Kriteri i notës mesatare minimale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave. Renditja e aplikantëve kryhet duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- i. 70% e notës mesatare aritmetike të shkollës së mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore;
- ii. dhe me 30% mesataren për lëndët e provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore. Lëndët me zgjedhje të maturës shtetërore janë si vijon: - Histori 15%, - Qytetari 15%.

Kriteret specifike hyrëse në këtë program studimi me bursë:

- Studentët të cilët aplikojnë për gjysmë bursë studimi, duhet që të kenë notë mesatare nga 9-9.5 dhe,
- nga 9.5-10 për përfitimin e bursës së plotë të studimit.

Sipas nenit 39 të “Rregullores së Fakultetit të Drejtësisë” (Evidenca nr.9) kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Sipas nenit 46, shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga pesë e lart janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati kthehet detyrimisht në notë. Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara të cilat vulosen nga sekretaria mësimore (neni 49).

Sipas “Rregullores së Diplomimit” (evidencë 19), diploma në ciklin e parë të studimeve, mbrohet me provim ose me temë diplome. Kriteri për përcaktimin e mbrojtjes me temë apo provim, të diplomës së studimeve të ciklit të parë, “Bachelor”, është mesatarja e vlerësimeve të arritura nga studenti deri në semestrin e pestë përpara diplomimit. Mesatarja vendoset çdo vit nga Këshilli i Fakultetit, duke mbajtur parasysh ecurinë dhe rezultatet e brezit përkatës. Në çdo rast, mesatarja e përgjithshme duhet të jetë jo më pak se nota 9 (nëntë). Provimi ose tema e diplomës vlerësohen me notë dhe kredite ECTS. Studentët e ciklit të parë që nuk plotësojnë kriterin e mesatares, për të mbrojtur temë diplome, i nënshtrohen provimit të formimit.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Studentët në këtë program studimi “Bachelor” në “Drejtësi”, pranohen sipas kriterit të notës mesatare minimale të përcaktuar me VKM. Nuk ka ndonjë kriter tjetër në lidhje me notën mesatare minimale të vendosur nga KU “Luarasi”.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Sipas të dhënave të RVB-së, nota mesatare në hyrje e studentëve për vitet akademike 2012-2018 ka variuar nga 7 në 8.3. Nota më e lartë në hyrje ka qënë në vitin akademik 2012-2013 dhe nota mesatare më e ulët në hyrje ka qënë në vitin 2014-2015.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 19 e Aneksëve):

Sipas të dhënave të RVB (Tabela 17, fq. 53), në vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 31 studentë për herë të parë, me notë mesatare 8.3 në hyrje; në vitin akademik 2013-2014 janë regjistruar 52 për herë të parë, me notë mesatare 8.03 në hyrje; në vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar 62 për herë të parë, me notë mesatare 7 në hyrje; në vitin akademik 2015-2016 janë regjistruar 66 për herë të parë, me notë mesatare 7.4 në hyrje; në vitin akademik 2016-2017 janë regjistruar 75 për herë të parë, me notë mesatare 8.1 në hyrje; në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 96 për herë të parë, me notë mesatare 7.9 në hyrje; në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 105 për herë të parë, me notë mesatare 8.1 në hyrje.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare (Tabela 20 e Anekseve)

- për vitin akademik 2012-2013 janë 59 studentë të diplomuar;
- për vitin akademik 2013-2014 janë 32 studentë të diplomuar;
- për vitin akademik 2014-2015 janë 76 studentë të diplomuar;
- për vitin akademik 2015-2016 janë 72 studentë të diplomuar;
- për vitin akademik 2016-2017 janë 77 studentë të diplomuar;
- për vitin akademik 2017-2018 janë 57 studentë të diplomuar.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Bazuar në aktet juridike të brendshme (Statuti dhe Rregullorja) KU "Luarasi" ka krijuar një strukturë akademike për shqyrtimin e dokumentacionit përkatës; marrjen e vendimit të pranimit apo jo për të vijuar studimet pranë këtij institucioni; ekuivalentimin e lëndëve përkatëse sipas krediteve të fituara nga institucioni përcjellës në raport me ato që në programin konkret të studimit janë. Komisioni i krijuar (Komisioni i Ekuivalentimit), merr vendimet rast pas rasti duke përcaktuar vitin akademik në të cilin studenti i pranuar do të vijojë studimet, si dhe, përcakton numrin e krediteve të njohura dhe ato që duhet të marrë në vijim të programit përkatës të studimit.

Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela 20 e Anekseve)

Nga të dhënat e RVB-së, GVJ konstaton që raporti i të punësuarve me ata që kanë përfunduar këtë program studimi është:

- për vitin akademik 2012-2013: nga 59 të diplomuar, 30 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 8 studentë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 81% e të diplomuarve janë punësuar.
- për vitin akademik 2013-2014: nga 32 të diplomuar, 27 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 5 studentë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 100% e të diplomuarve janë punësuar.
- për vitin akademik 2014-2015: nga 76 të diplomuar, 38 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 12 studentë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 66% e të diplomuarve janë punësuar.
- për vitin akademik 2015-2016: nga 72 të diplomuar, 43 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 18 studentë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 85% e të diplomuarve janë punësuar.
- për vitin akademik 2016-2017: nga 77 të diplomuar, 46 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 12 studentë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 75% e të diplomuarve janë punësuar.
- për vitin akademik 2017-2018: nga 57 të diplomuar, 23 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 17 studentë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën. 70% e të diplomuarve janë punësuar.

Numri total të diplomuarve (Tabela 20 e Anekseve)

Numri total i të diplomuarve nisur nga të dhënat e RVB (faqja 54) nga viti 2012 deri në vitin 2018 janë diplomuar 373 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën) (Tabela 20 e Anekseve)

Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën, për vitet akademike 2012-2018 është 207 studentë.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) (Tabela 20 e Anekseve):

Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën, për vitet akademike 2012-2018 është 82 studentë.

Duke u bazuar në dokumentin e vënë në dispozicion të GVJ gjatë vizitës në institucion rezulton që në grupin e kompanisë HB janë punësuar çdo vit akademik të diplomuar nga ky program studimi si më poshtë:

- ✓ Për vitin 2013 është punësuar një i diplomuar;
- ✓ Për vitin 2014 është punësuar një i diplomuar;
- ✓ Për vitin 2015 është punësuar një i diplomuar;
- ✓ Për vitin 2017- 2018 janë punësuar 8 të diplomuar;
- ✓ Për vitin 2018 janë në Internship dy të diplomuar;
- ✓ Për vitin 2019 është punësuar një i diplomuar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Evidencë punësimi & Internship të studentëve të KU "Luarasi" pranë HB Group

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Në këtë program studimi të ciklit të parë procedura dhe kriteret e pranimit të kandidatëve është në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e KU "Luarasi", si edhe Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Drejtësi". Kuotat dhe kriteret specifike të pranimit bëhen publike në portalin e KU "Luarasi" dhe në Portalin UAlbania. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konstaton që institucioni të përdorë kritere të tjera vlerësuese përveç atyre që janë të detyrueshme nga aktet ligjore në fuqi. Për aplikimin e bursave të plota dhe gjysëm bursat aplikohet kriteri i notës mesatare 9-9.5 dhe nga 9.5-10.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve; Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit; Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës; Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	Informimi në lidhje me programin e studimit të këtij cikli të parë në Drejtësi, ofrohet përmes fushatave informuese në shkollat e mesme (përmes koordinimit me MASR dhe me DAR, ZA). Këto fushata informuese organizohen nga institucioni përmes stafit akademik dhe studentëve në "takime informuese" me maturantët. Stafi akademik, administrativ dhe studentët e këtij institucioni dhe të këtij programi studimi informojnë në lidhje me programet e studimit, tarifatat e shkollimit, bursat etj. Institucioni është pjesëmarrës në panairt e

edukimit apo punësimin, duke prezantuar ofertën e tij akademike.

Pranë institucionit në mënyrë të përvitshme, organizohen ditët e hapura, të cilat ofrojnë mundësinë e njohjes së maturanëve me ambientet dhe shërbimet e këtij institucioni.

Ky program studimi është i publikuar në portalin dhe faqen e institucionit në internet dhe është i disponueshëm për studentët edhe përmes Sekretarisë Mësimore.

Në fillim të zhvillimit të çdo lënde/moduli përkatës, studentët informohen rreth: përmbajtjes; literaturës; komponentëve të vlerësimit dhe mënyrës së vlerësimit. Staf i akademik e zhvillon javën e parë të çdo semestri edhe si një javë diskutimi mes studentëve, në lidhje me përmbajtjen e lëndës (informacion nga takimi me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion).

Për çdo komponent vlerësues nga ana e pedagogut përkatës, studentët informohen përmes komunikimit me pedagogun ose përmes sekretarisë mësimore. Rezultatet e vlerësimit bëhen të njohura përmes një procesi transparent. Studentët plotësojnë në çdo semestër pyetësorët në lidhje me vlerësimin për performancën e pedagogut dhe për komponentë të programit mësimor përkatës. Pyetësorët plotësohen në mënyrë krejtësisht konfidenciale dhe që nga viti akademik 2017-2018, ky proces kryet on-line.

Në këtë institucion është funksionale dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbimin e këshillimit të studentëve. Kjo strukturë zhvillon trajnime ekstrakurrikulare, internship-e dhe praktika të ndryshme profesionale në institucionet publike dhe private me të cilat kjo zyrë ka komunikime të vazhdueshme.

Zyra e Këshillimit të Karrierës asiston studentët në aplikime për vende pune. Përmes orientimit në hartimin e një CV apo të komunikimeve të tjera të prezantimit për një punësim të mundshëm.

Praktikat profesionale pranë institucioneve ndihmojnë studentët për të krijuar kontakte punësimi pas përfundimit të studimeve. Kjo zyrë mundëson pajisjen e studentëve me dokumentin zyrtar të kryerjes së praktikës.

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;
Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

KU "Luarasi" mban në mënyrë të përditësuar statistika për numrin e të diplomuarve. Këto të dhëna raportohen periodikisht vit pas viti pranë MASR. Të dhënat e të diplomuarve mbahen në regjistrin bazë të studentëve.
 Të dhënat e studentëve në lidhje me ecurinë e tyre akademike janë në formë elektronike dhe të shkruar. Në regjistrin bazë të studentëve pasqyrohen notat për secilin student.

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është një strukturë e përcaktuar në Statutin e KU "Luarasi" (neni 66), akt i miratuar me Urdhërin Nr. 55, dt. 27.10.2016 të MAS.
 Kjo zyrë funksionon pranë rektoratit dhe misioni i saj është: rekrutimi i studentëve të rinj; kontaktet me këshillat studentorë; promovimi i studentëve; këshillimi dhe orientimi profesional i tyre; kontaktet me tregun e punës; mbajtja e të dhënave me të diplomuarit; përgatitja e librit të karrierës.
 Zyra drejtohet nga një koordinator, i cili emërohet nga Rektori. Në mbledhjen e rektoratit të datës 27.10.2018 është përcaktuar funksionimi i saj me dy departamente: Departamentin e studentit dhe Departamentin e këshillimit të karrierës. Me urdhërin e Rektorit Nr. 10, datë 08.11.2018, janë emëruar dhe personat përgjegjës të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (*dokument i vënë në dispozicion të GVJ gjatë vizitës së institucionit*). Ky strukturim i ri i kësaj zyre synon të të ndjekë më mirë zhvillimin e praktikave dhe rritjen e mundësive për internship dhe punësim. Departamenti i Studentit synon të përmirësojë procesin e rekrutimit të studentëve dhe informimin e studentëve të regjistruar në lidhje me programet mësimore që ofron KU "Luarasi". Sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ gjatë vizitës në institucion (*dokument i hartuar nga përgjegjësja e zyrës J.Gj.*) Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës synon që përmes riorganizimit të ri, të përmirësojë pjesëmarrjen e studentëve në panairt e punësimit që do të organizohen në kampusin e KU "Luarasi"; këshillimin e karrierës për studentët Alumni; statistika të përditësuara për praktikat mësimore; krijimin e zyrës së trajnimeve; krijimin e zyrës

së operimit, me fokus grupe për trajnime dhe ëorkshope lidhur me këshillimin.

Departamenti i Këshillimit të Karrierës ka planifikuar për vitin akademik 2018-2019: intervistimin e studentëve në lidhje me interesat e tyre për punësim, me qëllimin e krijimit të një databaze për lidhjen e këtyre të dhënave me kërkesat e tregut të punës; identifikimin dhe informimin e studentëve mbi oportunitetet edukative të KU "Luarasi" apo partnerëve të tij, në lidhje me shkollat verore; internshipe; trajnime; bursa studimore; kurse online, etj

Për zhvillimin e praktikës mësimore miratohet me vendim të dekanit lista e pedagogëve mbikqyrës me emrat e studentëve përkatës (sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ-së gjatë vizitës në institucion Vendimi Nr.6, dt.02.08.2018).

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Në çdo fillim semestri akademik, studentët informohen në lidhje me përmbajtjen e çdo lënde/moduli të kurrikulës. Ky informacion lidhet me: përmbajtjen; literaturën e aksesueshme në bibliotekën e KU "Luarasi"; komponentët e vlerësimit përgjatë semestrit akademik dhe mënyrën e vlerësimit. Staf i akademik është i hapur për të bërë ndryshimet e nevojshme të syllabusit në javën e parë të fillimit të procesit mësimor, kur këto ndryshime propozohen nga studentët dhe gjykohe si të arsyeshme.
2. Studentët informohen për çdo komponent vlerësues nga ana e pedagogut përkatës, përmes një procesi transparent.
3. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, një strukturë e përcaktuar në Statutin e KU "Luarasi", është riorganizuar me Urdhër të Rektorit, për një funksionim sa më akademik dhe operativ. Kjo zyrë e përbërë tashmë nga dy departamente (Departamenti i Studentit dhe Departamenti i Këshillimit të Karrierës), synon të përmirësojë shërbimet për studentët e rinj dhe atë në prag diplomimi, si dhe, për mundësinë e një karriere sa më të përshtatshme profesionale për të diplomuarit.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësi, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kolegji Universitar "Luarasi" për vitin akademik 2018-2019, është riorganizuar me tre njësi kryesore, duke përfshirë në strukturën e tij akademike dhe "Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" i krijuar si njësi kryesore me Urdhër Nr. 266, datë 14.05.2018 i MASR. Kjo njësi e re akademike do të synojë të nxisë edhe më shumë kërkimin shkencor inovativ.

Institucioni ka hapur thirrjen për Projekte Kërkimore Individuale/në grup për vitin akademik 2018-2019 me afat aplikimi deri në 15 Shkurt 2019 (sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ, gjatë vizitës në institucion "Planifikimi i Kërkimit Shkencor për vitin akademik 2018-2019").

Programi i studimit "Bachelor" në "Drejtësi" zhvillohet me një fokus në zhvillimin e kërkimit shkencor në funksion të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, duke mundësuar krijimin e hapësirës së mundshme akademike për rritjen e kapaciteteve kërkimore të stafit akademik. Kjo duket që realizohet si përmes trajnimeve të ndryshme me fokus në kërkimin shkencor ashtu dhe nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës me partnerët vendas dhe të huaj, të cilët ftohen nga ana e institucionit për të dhënë një kontribut në këtë kuadër. Në KU "Luarasi", kërkimi shkencor është i përqëndruar: në nivel departamenti, ku përmes tij kjo njësi inicion zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore; në nivel institucioni, ku përmes kësaj njësi sigurohet bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Pranë KU "Luarasi" publikohet revista periodike "Mendimi" me ISSN 2311-0961, e cila përmban punime shkencore të stafit akademik të këtij institucionit, si dhe, punime të studiuesve të tjerë jashtë tij. Stafi akademik i Fakultetit të Drejtësisë publikon në mënyrë periodike pranë kësaj reviste shkencore.

Nga viti akademik 2017-2018, përmes një projekti bashkëpunues me Fondacionin "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", me fokus në dhënien e ndihmës juridike falas për personat në pamundësi ekonomike për të përballuar përfaqësimin nga avokati, realizohet përfshirja e studentëve dhe stafit akademik të Fakultetit të Drejtësisë. Ky projekt bashkëpunues është sa me natyrë akademike aq dhe me natyrë shkencore, pasi jo vetëm është në funksion të kurrikulës akademike, por edhe të zhvillimit të shkencës juridike përmes njohjes së praktikës. Përmes projektit të Klinikës së Ligjit, mundësohet simulimi i proceseve gjyqësore, ku studentët të mësojnë mënyrën se si procedohet në procese penale, civile dhe administrative. Studentët përfshihen në mënyrën si procedohet në një proces gjyqësor. Lënda "Klinika Ligjore" është dizenuar në këtë program studimi, duke u bazuar në përvojën e arritur nga ky projekt bashkëpunues.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 21 e Anekseve)

Sipas të dhënave që gjenden në RVB, veprimtaria kërkimore shkencore është e fokusuar në:

- ✓ Botimet dhe publikimet shkencore në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të realizuara nga ana e stafit akademik të këtij programi studimi (Prof.Asc.Dr. R.K - 2 konferenca; Dr. D.Gj - 2 konferenca; Dr. B.Sh - 3 konferenca; Prof.As. L.V - 3 konferenca; Prof.Asc.Dr. H.V - 2 konferenca; Doc. V.K - 1 konferencë; Msc. S.V - 3 konferenca; Msc. B.F - 1 konferencë; Msc. A.K - 2 konferenca; Msc. J.Gj - 2 konferenca; Dr. B.M - 1 konferencë; Msc. S.P - 2 konferenca; Dr. E.B - 1 konferencë);
- ✓ Projekte të fituara dhe të zbatuara - 1 projekt;
- ✓ Aktivitete shkencore të organizuara nga Institucioni për këtë program studimi - 7 aktivitete për periudhën 2017-2018;
- ✓ Aktivitete shkencore të organizuara nga institucioni - 9 aktivitete;
- ✓ Kërkime shkencore të lidhura me procesin mësimor (në formën e leksioneve të hapura me pedagogë vendas dhe të huaj) - 15 leksione të hapura;
- ✓ Studentë të përfshirë në kërkimin shkencor - 7 studentë (për vitet 2009- 2015) dhe 3 studentë për periudhën 2014-2015;
- ✓ Çmime kombëtare të fituara nga studentët - 2 çmime. 1 çmim në Nëntor 2016 në konkursin ndërkombëtar të iniciuar nga Youth Development Group dhe tjetri në Dhjetor 2016, i akorduar nga Ambasada e Izraelit për esenë më të mirë.

Institucioni buxheton Kërkimin Shkencor në zërat: konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare; konferenca studentore; blerje librash; bibliotekën online; leksione të hapura dhe forume studentore

(sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ-së gjatë vizitës në institucion "Buxheti për Aktivitetet Kërkimore Shkencore (përfshirë literaturën për bibliotekën").

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Buxheti për Aktivitetet Kërkimore Shkencore (përfshirë literaturën për bibliotekën)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar "Luarasi" ka ndërtuar marrëdhënie partneriteti me Institucione të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja dhe komunitetin e biznesit. Në funksion të tyre KU "Luarasi" ka në strukturën e tij dhe Zyrën e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Më së shumti, qëllimi i bashkëpunimeve fokusohet në mundësimin e praktikave profesionale, si pjesë e programeve të studimit që ofron, ku përfshihet dhe Bsc në "Drejtësi". Gjithashtu, marrëveshjet e mundësuar synojnë të adresojnë edhe çështje të tjera si: organizimin e veprimtarive të përbashkëta; mobilitetin e studentëve; botime e kërkim shkencor etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 22 e Anekseve)

GVJ, në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe verifikimit gjatë vizitës në vend, identifikon:

1. Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare - 4
2. Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore - 15
3. Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit - 2
4. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL - 2 studentë të angazhuar
5. Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor - 2 laboratore; Biblioteka; Qendra FAB; 5 Media të shkruar dhe vizive
6. Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime - 1 prezantim në Universitetin La Sapienza, Itali
7. Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor - 1 Çmim i fituar në Konkurs ndërkombëtar i iniciuar nga Youth Development Group

GVJ vlerëson se ka një qasje për motivimin e stafit akademik të brendshme për realizimin e publikimeve dhe konferencave, në kuadër të zhvillimit akademik. Institucioni duhet të marr masa për intergrimin në numër më të lartë të studentëve në këtë program studimi në aktivitetet dhe botimet shkencore.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 23 e Anekseve)

1. Institucioni, sipas evidencave, ka krijuar marrëveshje bashkëpunimim me 10 institucione qeveritare në funksion të praktikave, konferencave të përbashkëta, shkëmbim stafi etj;

2. Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare, rezulton të jetë 3 projekte nga të cilat 1 Erasmus +;
3. KU "Luarasi" ka mundur të krijojë bashkëpunim me 5 ente private (tregu i punës), nga të cilat 1 është ndërkombëtare në funksion të realizimit të praktikave dhe promovimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni është angazhuar për krijimin e urave të bashkëpunimit institucional me partnerë lokal dhe ndërkombëtar ndër të cilët GVJ konstaton: Gjykatën e Apelit Tiranë; Biznes Albania; Avokati i Popullit; KLSH; Universitetin e Salentos, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, të cilat i shërbejnë drejtpërdrejtë programit të studimit Bsc në "Drejtësi".</p> <p>GVJ konstaton angazhim të institucionit në ofrimin e leksioneve të hapura nga personalitete kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës (evidenca Nr. 45 në DVV) dhe motivon stafin e personelin e tij të brendshëm në ndjekjen dhe aktivizimin e tij në këtë prizëm.</p> <p>Institucioni ka krijuar një klimë bashkëpunuese dhe rakorduese midis strukturave të tij akademike dhe administrative duke nxitur ndërveprimin midis tyre në funksion të transparencës dhe rritjes së cilësisë.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>GVJ, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vetëvlerësimit dhe vizitës në vend, konsatoi se Institucioni është angazhuar në krijimin e marrëdhënieve të dedikuara të bashkëpunimit. Referuar Evidencës Nr. 21 të DVV, evidentohen një sërë bashkëpunimesh dhe objekti i tyre.</p> <p>GVJ konstaton se marrëveshjet kanë objekte të shumëllojshme që variojnë nga shkëmbim stafi dhe studentësh; organizim konferencash dhe seminaresh; zhvillimin e praktikave profesionale etj.</p> <p>Institucioni ka marrë pjesë në një thirrje të Erasmus +, për shkëmbin studentësh me Universitetin Istanbul Sehir për 3 studentë në total. GVJ duke e konsideruar këtë si pjesë të nevojshme të rritjes së</p>

studimeve.

cilësisë e motivon institucionin në aktivizimin më dinamik në projekte të tilla.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka një qasje të hapur drejt bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, në funksion të realizimit të programit të studimit.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit karakterizohen nga objekte të shumëfishta për adresimin e nevojave të Institucionit si seminare; konferenca; promovime; praktika mësimore.
3. Institucioni duhet të jetë me aktiv në funksion të aplikimit të projekteve ndërkombëtare si Erasmus +.
4. Ku “Luarasi” duhet të ndërmarrë masa për përfshirjen më të madhe të studentëve të këtij programi studimi në kërkimin shkencor dhe projekteve te brendshme të aplikuara.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke u nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga Institucioni dhe për aq sa konstatoi nga vizita pranë tij, i konsideron rekomandimet e lënë nga akreditimi i mëparshëm për këtë program studimi si të plotësuar plotësisht në masën mbi 80%, pasi vetëm një nga pesë rekomandimet nuk është plotësuar plotësisht. GVJ nuk adreson ndonjë rekomandim konkret, përveç atyre për të cilat është shprehur përgjatë raportit.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT)

a. Pika të forta:

1. Përmes programit të studimit "Bachelor" në Drejtësi, fakulteti përkatës ofron dhe mundëson përmes studentëve dhe stafit akademik pranë këtij programi, dhënien e shërbimeve juridike tek të tretët. Ky mision mjaft akademik dhe social-juridik është mundësuar edhe përmes projekteve që realizohen në kuadër të bashkëpunimit institucional.
2. Fakulteti i Drejtësisë (në të cilit ofrohet ky program studimi) në mënyrë të vazhdueshme përmirëson përmbajtjen e plan-programeve të lëndëve, duke i përshtatur ato me ndryshimet që legjislatiioni dhe institucionet e drejtësisë në vend pësojnë kohë pas kohe. Kjo u mundëson studentëve të këtij programi marrjen e dijeve dhe informacionit të lidhur me ndryshimet më aktuale.
3. Përmirësimi i kurrikulës në këtë program studimi bëhet në drejtim të ofrimit të dijeve në formën teorike dhe praktike, duke shtuar në këtë kurrikulë lëndë, të cilat lidhen ngushtësisht me praktikën gjyqësore.
4. Në funksion të këtij programi studimi janë dhe organe të tjera ndihmëse akademike dhe administrative si pjesë e strukturës së institucionit (të përcaktuara në Statut), të cilat realizojnë përmbushjen e komponentit mbështes akademik për studentët (Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës).
5. Institucioni buxheton në mënyrë të vazhdueshme elemente të procesit akademik dhe kërkimor-shkencor në drejtim të mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në organizim të konferencave nga dhe për studentët.

b. Pika të dobëta:

1. NJSBC të definojë me saktë funksionet e saj si njësi administrative me detyra të qarta dhe përshkrime pune për të gjithë anëtarët e saj.
2. Institucioni ka angazhuar si titullarë lëndësh, pedagogë me kualifikimin "Master Shkencor" të cilën GVJ e identifikon si nevojë për përmirësim.

c. Mundësitë:

1. Institucioni, përmes reputacionit të mirë dhe eksperiencës në ofrimin e programeve të studimit të arsimit të lartë ka hapësirën e mundshme për përthithjen e stafit me kualifikim më të lartë në tituj dhe grada.
2. Infrastruktura në funksion krijon mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të programit.

d. Pengesat:

GVJ nuk gjen asnjë pengesë për përmbushjen e kriterëve të duhura ligjore të evidentuara.

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të përfshirjë në mënyrë të vazhdueshmë studentët e këtij programi studimi në kërkim shkencor.
2. Institucioni duhet të përcaktojë përmes akteve nënligjore jo vetëm funksionimin e njësisë NJSBC që vepron si e përhershme, por edhe duhet të sanksionojë përmes kontratave rolin dhe angazhimin e secilit prej anëtarëve që është pjesë e saj.
3. Institucioni duhet të marrë masat e duhura për angazhimin si titullarë lëndësh vetëm të pedagogëve me titullin përkatës akademik.
4. GVJ vlerëson angazhimin e Institucionit për ofrimin e librarisë online “Questia”, megjithatë rekomandohet që biblioteka fizike të pasurohet me fonde librash e sidomos periodikëve të fushës.
5. Institucioni duhet të jetë me aktiv në funksion të aplikimit të projekteve ndërkombëtare si Erasmus +.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EER - SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

a. Strengths:

1. The Faculty of Law through this study program offers legal services to third parties through its students and academic staff. This highly academic and socio-legal mission is enabled through projects that are realized within institutional cooperation.
2. The Faculty of Law continuously improves the content of courses and curricula by adapting to changes that legislation and judicial justice vary from time to time. This enables students of this program to acquire knowledge and information about the most current changes.
3. Improving the curriculum in this study program is aimed at providing theoretical and practical knowledge, adding to some courses what is most important for judicial practice.
4. As part of this study program, there are several administrative bodies as part of the institution structure (defined in the Statute), which complement the academic support component for students (Student Office and Career Office).
5. The institution continuously finances the elements of the academic and research process, in terms of support for participation in national and international conferences, as well as in organizing conferences for and from students.

b. Weaknesses:

1. QAU should provide a more clear definition of its functions as an administrative unit, with clear tasks and job descriptions for its members.
2. The institution has engaged lecturers with the qualification “Master of Science” as subject responsible, which External Evaluation Team finds as a need to improve.

c. Opportunities:

1. The institution, throughout its good reputation and experience in offering higher education study programs has the possible opportunity to recruit higher qualified academic staff, with titles and grades.
2. The infrastructure in place provides opportunity to further develop the study program.

d. Threats:

The External evaluation team didn't find any threats for the implementation of the identified legal criteria.

Recommendations:

1. The institution should involve in a more continues and broad way the students of this study program in the scientific research.
2. The institution should through acts issued by the institutional bodies, determine not only the activity of the QAU as a permanent unit, but also to determine by contract the role and engagement of each member of the QAU.
3. The institution should undertake the appropriate actions to engage as the first lecturer only academic staff with the respective academic title.
4. The external evaluation experts evaluate the Institution's commitment to providing the Questia online library, but it is recommended that the library be enriched with book funds and especially periodicals in the field.
5. The institution should be more active in applying international projects such as Erasmus +.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Enkeleda Olldashi
2. ME. Tildi Çadri

